

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7633 E hënë 27 Gusht 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje në "Europa e lirë!"  
Nënshkrimi i një dokumenti juridikisht obligues me Kosovën, për Serbinë do të nënkuptonte edhe ndryshimin e Kushtetutës së saj, vlerësojnë njohës ...  
Vijon në faqen 20

Nga BEKIM BISLIMI  
Korrigjimi i kufijve e fshin Kosovën nga Kushtetuta e Serbisë



Analiza e Ditës  
Pak ditë më parë, zv/kryeministri i parë e njëkohësisht ministër i Jashtëm i Kosovës, Behgjet Pacolli, brenda të gjithë rregullave diplomatike, kërkoi leje ...  
Vijon në faqet 10-11

Nga SPARTAK TOPOLLAJ  
Kur edhe Ivica Dačić tenton të japë leksione qytetarie?!



INTERVISTA  
Kreu i PDK-së: Basha me mendësi europiane  
**Zgjedhjet, Ndoka: Tre kandidatët e fortë të opozitës përballë Veliajt**

"Jorida Tabaku lidhje të forta me kryeqytetin, Klajda Gjoshja, kandidatë potenciale, Dashamir Shehi, politikan popullor".  
VALENTINA MADANI  
Nard Ndoka kreu i PDK-së, i kërkon liderit të opozitës Lulzim Basha që t'i garantojë qytetarët që po largojmë një qeveri të korruptuar, të gjuhëzuar përpara krimin dhe po vjen një ekip, që ofron zgjidhje, garanton ...  
Në faqet 2-3

## ZBARKIMI, 20 REFUGJATE DO TE VIJNE NE SHQIPERI AKOMODIMI, PERPLASJA PER EMIGRANTET AFRIKANE

Italia falënderon Shqipërinë, opozita sulmon qeverinë.  
PD: Qesharake, fqinjët t'i ndihmojnë duke luftuar kanabisin.



(Në foto) Emigrantët Afrikanë në Itali

- AKUZAT**  
Krimet e Rëndat nisin hetimet për pasurinë e Edmond Begos  
Në faqen 6
- DENONCIMI**  
Digjet makina e nënkryetarit të Bashkisë së Mallakastrës, policia: E qëllimshme  
Në faqen 6
- DEBATI**  
Kaceli: Pse të internuarit marrin nderim nga komunistët?  
Në faqen 18

DOSSIER NGA DASHNOR KALOÇI  
  
**Flet motra e Bardhok Bibës: Si i godita komunistët**  
Në faqet 8-9

Rektori: Mbi 80% e të diplomuarve janë punësuar brenda 6-muajsh  
**Rreth 1200 maturantë përzgjedhin "Luarasin"**  
Ethem Ruka: Rritet me 256% numri i aplikimeve

Nga VOLTIZA DURO  
Rreth 1200 maturantë Rnë mbarë vendin kanë përzgjedhur të vazhdojnë studimet e larta në universitetin 'Luarasi' për vitin e ri akademik 2018-2019. Rezultatet e publikuara nga Ministria e Arsimit



tregojnë një rritje të dukshme prej 256% të numrit të aplikimeve drejt këtij universiteti, krahasuar me një vit më parë. Rektori i "Luarasit" prof.dr. Ethem Ruka tregon se falë standardeve të larta të mësimdhënies dhe kredibilitetit ...  
Në faqen 7

**LIFE PAGES**  
**Impotenca, Arqile Gjirkondi: "Si të kuroni prostatën e irrituar"**  
Suplement

## STRATEGJIA E OPOZITES

### INTERVISTA

Kreu i PDK: Donald Lu humbi betejën e kauzën, humbi besimin e opozitës dhe qytetarëve

# Ndoka: PS të zbrapset nga aventurat e saj, të ofrojë kompromis

"Opozita ka potenciale për katër ekipe qeverisëse"

Valentina Madani

**N**ard Ndoka kreu i PDK-së, i kërkon liderit të opozitës Lulzim Basha që t'i garantojë qytetarët që po largojmë një qeveri të korruptuar, të gjuhëzuar përpara kriminit dhe po vjen një ekip, që ofron zgjidhje, garanton shpresë dhe besim për të ardhmen e tyre. Ndoka beson se bashkëpunimi me LSI-në ka rezultuar efikas dhe pozitiv, duke e paraqitur opozitën e bashkuar si një institucion programor, sipas tij përballë qeverisë së 'tepsisë dhe kazarit'. Por aleati i Bashës zbulon për "Gazeta Shqiptare" tri kandidataturat e forta të opozitës në garën për kryebashkiakun e ri të Tiranës përballë Erjon Veliaj.

Nard Ndoka vlerëson se Jorida Tabaku është personazh në rritje në politikën shqiptare dhe se ka personalitet, dinjitet, eksperiencë dhe lidhje të forta me kryeqytetin. "Opozita ka mjaft emra dinjitozë për Tiranën: Klajda Gjoshja, kandidatet potenciale dhe politikanë karriere, Dashamir Shehi, politikan popullor, manaxher brilant, i dashur dhe babaxhan për tiranasit, mediatik dhe karizmatik", shprehet z.Ndoka. Ai është i sigurt se përballja në Tiranë nuk do të jetë e vështirë pasi sipas Ndokës, "demagogjia e Veliajt, konsumi moral dhe menaxherial, nënshkrimi për keqkëqerisjen lokale e qendrore, e bëjnë të lehtë fitoren e kandidatit të opozitës së bashkuar".

**Z.Ndoka, opozita po përgatitet për aksionin e ri politik kundër qeverisë Rama' por sipas jush cila do të ishte rruga më e efikase që të çon drejt rre-**



Kryetari i PDK-së Nard Ndoka

"Lu me gjasa ishte produkt diplomatik i "Soros" dhe kishte marrë udhëzime që drejtësia të mbetej nën kontrollin e tyre për më tej. Lu humbi betejën e kauzën, humbi besimin e opozitës dhe qytetarëve, por do humbë edhe Ramën e Soros. Lu mbetet një mësim për opozitën e politikën në tërësi", - tha kreu i PDK-së.

**zimit të Edi Ramës nga pushteti?**

Aksioni politik i opozitës duhet t'i paraprijë lëvizjes dhe shqetësimit qytetarë në rritje. Nuk është qëllim në vetvete pushteti; por standardet, zbatimi i ligjit, korrupsioni, droga, grupet kriminale, pasiguria, papunësia, varfëria dhe shumë e shumë probleme të tjera sociale, që shqetësojnë sot çdo familje dhe qytetarë shqiptarë. Opozita duhet të jetë impulsive, e fortë, e vendosur; duke u organizuar si alternativë qeverisëse dhe si garanci për të ardhmen. Protesta është rruga fundore, por kërkohet një opozitë frontale në Kuvend, në takime me grupet e interesit dhe qytetarët, në çdo fshat e qytet, duke ngritur ndjeshmërinë e përgjegjësinë qytetare dhe politike për t'i dalë zot vendit. Çdo njeri sot, mendon si të largojmë Ramën nga pushteti, ndaj është detyra e opozitës që të gjejë rrugë për ta realizuar sa më parë.

**Një opsion është edhe bojkoti i Kuvendit apo dështimi i mandateve...?**

Opozita ka shumë mundësi dhe rrugë për t'u ringritur si alternativë; lënia e mandateve është pika kulmore, ku duhet të ndahemi përfundimisht nga mundësitë e bashkëpunimit institucionale me mazhorancën.

**Po me PD-në ku ndahemi dhe bashkohemi në betejën për rrëzimin e**

qeverisë?

Nuk ka diferencë në qëndrimet mes opozitës, dikush kërkon rrugë më të shkurtra, dikush tjetër kërkon marrjen e përgjegjësisë; për dje, sot dhe për nesër. Opozita dhe Z.Basha duhet t'i garantojë qytetarët që po largojmë një qeveri të korruptuar, të gjuhëzuar përpara kriminit dhe po vjen një ekip, që ofron zgjidhje, garanton shpresë dhe besim për çdo qytetar.

**Sipas jush bashkëpunimi me LSI po e ndihmon apo po e dëmton PD? Ju jeni për një koalicion të përbashkët PD-LSI për zgjedhjet e ardhshme lokale?**

Bashkëpunimi me LSI-në ka rezultuar efikas dhe pozitiv, duke e paraqitur opozitën e bashkuar si një institucion programor, përballë qeverisë së tepsisë dhe kazarit.

Porcimi i bashkëpunimit, axhenda e përbashkët, programi minimal dhe strategjitë për të ardhmen duhet të jenë kryefjala për më tej. Opozita e Bashkuar po tregon përngjashmëri dhe përgjegjësi për të ardhmen e vendit; debati, ide-të, alternativat, vendim-marrja e përbashkët janë

#### PËR LULZIM BASHËN

"Lulzim Basha është një lider, që të krijon mundësi dhe hapësirë, për t'i thënë gjërat, por edhe reagon shpejt duke treguar që ka formatin dhe garancitë institucionale, morale, politike dhe mendësi tipike europiane. Unë kam besim, se është momenti i opozitës dhe roli i liderit ka një rëndësi vendimtare për të gjithë", -tha Ndoka.



#### KRITIKET

"Ata krijuan një hendek mes lidhshimit dhe bazës së tyre, kjo nuk do të thotë, se shumë prej tyre i duhen akoma opozitës me idetë dhe eksperiencën e tyre. Është përgjegjësi e Bashës për t'i afruar dhe e tyre për të kuptuar drejt realitetin e ri. Berisha është një busull reale për to, model i një lideri, që qëndron dhe kërkohet nga baza, por që ditë ruajë pozicionin e artë politik që e shoqëron".

pikat e forta të Z.Basha në raport me aleatët dhe qytetarët.

Opozita është plurale në përbërje, me ide dhe alternativa programore konkurruese, duke rritur në maksimum mbështetjen popullore dhe besimin për qeverisje më të mirë nesër.

**Here pas here ju bëni ironi me kryeministrin, duke i vendosur epitetet në ndryshje, por edhe duke i dhënë "këshilla" nganjëherë. Çfarë ju shtyn të ironizoni kaq shumë?**

Kryeministri ka zgjedhur një rol qesharak në drejtimin e shtetit, ai po tallet me qytetarët shqiptarë. Ka pesë vite që merret me opozitën, nuk qeveris, nuk ka projekte konkrete, por vetëm demagogji pa fund.

Është në luftë me akademikët, me artistët, me sportin, me studentët, me biznesin, me qytetarët e thjeshtë dhe me çdo njeri që ka kurajën ta kritikojë.

Në këto rrethana një personazhi të tillë të pabërgjegjshëm, vetëm ironia dhe sarkazma mund t'i përgjigjen stilit dhe sjelljes së tij. Ai e ka kthyer politikën dhe qeverisjen në një grupë balte, ku derat kacafyten duke ngrënë njëri-tjetrin. Unë jam përkujtur që mos të futem në terrenin e tij me baltë. Nëse futesh aty, përballtosesh njësoj si kryeministri Rama. Edi Rama ka ndërtaur një shtet "ligjor" dordolecash, në qendër ka vendosur vetën për të trembur të tjerët; drejtuesit e institucioneve, nëpunësit, qytetarët dhe këdo tjetër. Promovon në teori shtetin ligjor; me ligje, vendime e udhëzime, por në praktikë; vendos një dordolec në krye për të frikësuar të tjerët dhe asgjë më shumë. Koha e tij ka mbaruar.

**Kritik dhe përballë të gjithëve, madje edhe me familjen tuaj politike,**



### QEVERISJA E RE

"Ne kemi potenciale dhe eksperiencia qeverisëse aq shumë, sa për të ndërtuar tre- katër ekipe qeverisëse. Basha ka drejtuar dy -tre ministri të rëndësishme që mbajnë firmën e tij për ngjarje të rëndësishme kombëtare, ndaj ka garancitë dhe besimin e aleateve, por edhe të qytetarëve, që është kryeministri i duhur për të drejtuar vendin", - tha z.Ndoka.

### OPOZITËN. PO NË GJYKIMIN TUAJ A ËSHTË E GABUESHME OPOZITA?

Unë jam natyrë opozitari i përjetshëm, kritikoj çdo fenomen që gjykoj që dëmton sistemin dhe institucionet. Jam një zë opozitë dhe brenda opozitës. "Furçat e lëpirjet" nuk janë arma ime politike, as nuk do jenë kurrë. Opozita ka gabimet e veta; në organizim, në çështje parimore, programore dhe ndjehet mungesa besimi herë pas here. Janë tema debati në takimet tona opozitare dhe shumica e këtyre problemeve po marrin jetë, po provojmë dhe tentojmë mënyra dhe hapësira të ndryshme. Kur pranon gabimet dhe mendon dhe vendos për të ardhmen çdo gjë tjetër arrihet. Lulzim Basha është një lider, që të krijon mundësi dhe hapësira, për t'i thënë gjerat, por edhe reagon shpejt duke treguar, që ka formatin dhe garancitë institucionale, morale, politike dhe mendësi tipike europiane. Unë kam besim, se është momenti i opozitës

dhe roli i liderit ka një rëndësi vendimtare për të gjithë.

**Kjo është arsye që para disa ditësh, kur z.Berisha bëri thirrje për rrëzimin e qeverisë në shtator, ju shkruanit në 'Fb': 'Na prij Lulzim Basha...?'**

Ishte një revoltë e brendshme. Besoj se ka ardhur koha që z.Basha duhet të dalë mbi të tjerët në vendimmarrje të aksionit opozitar. Ai ka përgjegjësinë, detyrimin kushtetues, politik dhe qytetar për të ndarë momentin kur Opozita duhet të ndahet nga pritja e reflektimit të një mazhorance normale.

Megjithatë z.Basha vazhdon të kritikohet nga kundërshtarët e tij brenda partisë, ndërkohë që për kritikët e tij jeni shprehur se alternativa e vetme për ta ishte "rroftë Berisha". Është disi vështirë të besosh se është mbyllur epoka "Berisha" në PD...

Epoka 'Berisha' nuk është mbyllur në aspektin e vazhdimësisë dhe qëndrës, por unë kam citu-

ar; se ata nuk kishin mendim ndryshe në atë parti asnjë herë. Kur Berisha u tërhoq nga drejtimi, automatikisht edhe bashkëpunëtorët e tij, duhet të bënin një hap prapa. Koha duhet t'i lartësonte apo harronte në varësi të përkushtimit të tyre dhe lidhjes me bazën. Unë nuk kam gjykuar asnjë herë se ato duhet të largohen, përkundrazi shumë prej tyre kanë histori suksesi që kanë bërë edhe emër të mirë. Apo si rasti i Patozit që nuk ka patur asnjë herë funksione ekzekutive. Ata krijuan një hendek mes lidhshimit dhe bazës së tyre, kjo nuk do të thotë, se shumë prej tyre i duhen akoma opozitës me idetë dhe eksperiencën e tyre. Është përgjegjësi e Bashës për t'i afruar dhe e tyre për të kuptuar drejt realitetin e ri. Berisha është një busull reale për to, model i një lideri, që qëndron dhe kërkohet nga baza, por që di të ruajë pozicionin e artë politik që e shoqëron.

**Sa besues jeni se Lulzim Basha do t'i shkurtojë mandatin Edi Ramës?**

Lulzim Basha i dha një mundësi reale Edi Ramës, që të hynte në histori, si një politikan modern; që di të nënshkruajë marrëveshje historike për vendin. Lulzim Basha e ngriti veten e tij në lartësinë e përgjegjësinë e liderit ndaj vendit. I dha mundësinë vendit dhe Ramës të futej në shina institucionale e kushtetuese. Shmangu përplasjet politike dhe popullore, fitoi simpatinë e atyre që e ndjekin politikën shqiptare, humbi zgjedhjet, por fitoi besim dhe siguri tek të tjerët; se nuk është një politikan që kërkon pushtet, por përgjegjësi dhe rregulla. Rama, përmbysi gjithçka për tepsinë e tij, vodhi zgjedhjet, tradhdoi opozitën, përjashtoi dhe shkeli me këmbë aleatët. Sot ai po vuan agonin e tij. Ndaj sot Basha, nuk ka mundësi që të besojë te Rama dhe axhenda e tij. E vetmja mundësi është ndarja përfundimtare duke vendosur dhe diktuar rregullat e lojës.

**Nëse vendi shkon drejt zgjedhjeve të parakohs-**

"Basha një lider që të krijon mundësi dhe hapësira, me mendësi tipike europiane"

# Zgjedhjet, Ndoka: Tre kandidatët e fortë të opozitës përballë Veliajt

"Çfarë e bën të lehtë fitoren në Tiranë"



Kryetari i PD-së Lulzim Basha

### KANDIDATËT

"Jorida Tabaku është personazh në rritje në politiken shqiptare. Ka personalitet, dinjitet, eksperience dhe lidhje të forta me kryeqytetin. Opozita ka mjaft emra dinjitoz për Tiranën: Klajda Gjoshja, kandidatë potenciale dhe politikane karriere, Dashamir Shehi, politikan popullor, manaxher brilant, i dashur dhe babaxhan për tiranasit, mediatik dhe karizmatik", - deklaroi Nard Ndoka.

"Opozita dhe Z.Basha duhet t'i garantojë qytetarët që po largojmë një qeveri të korruptuar, të gjuhëzuar përpara kirit dhe po vjen një ekip, që ofron zgjidhje, garanton shpresë dhe besim për çdo qytetar", - deklaroi kreu i PDK-së .

**hme, a është e gatshme opozita t'i fitojë ato? A e ka Lulzim Basha besimin dhe garancinë e aleatëve për të kryesuar nesër qeverinë e re?**

Ne flasim sikur opozita është një lëvizje e krijuar dje; ne kemi potenciale dhe eksperiencia qeverisëse aq shumë, sa për të ndërtuar tre-katër ekipe qeverisëse. Basha ka drejtuar dy tre ministri të rëndësishme që mbajnë firmën e tij për ngjarje të rëndësishme kombëtare, ndaj ka garancitë dhe besimin e aleatëve, por edhe

të qytetarëve, që është kryeministri i duhur për të drejtuar vendin.

**Si e shikonin apelin e ndërkombëtarëve drejtuar opozitës për bashkëpunim me qeverinë me qëllim përmbushjen e reformave integruese, konkretisht atë të drejtësisë?**

Opozita ka dhënë kontributin maksimal për reformat dhe do të vazhdojë ta japë atë. Është mazhoranca, ajo që ka përmbysur konsensusin politik dhe ka shembur totalisht garancitë ligjore dhe kushtetuese, duke e kthyer vetënjohjen në një farsë dhe tendencë monopoli.

Mazhoranca duhet të zbrapsset nga aventura e saj, duke ofruar realisht kompromis dhe garanci për institucionet përfshi edhe opozitën, si garant të sistemit.

**Ambasadori amerikan Donald Lu ikën nga Shqipëria pa futur dot në 'rrejtë peshqit e mëdhenj' ndërkohë që opozita jo rrallë u përplas me të duke e akuzuar shpesh për bashkëpunim me Edi Ramën. Si pas jush për cilat arsye?**

Ambasadori Lu ektheu në kauzë personale reformën në drejtësi, duke parë një kryeministër të paafte dhe të gjuhëzuar në mëkatet e tij, ai me gjasa ishte produkt diplomatik i "Soros" dhe kishte marrë udhëzime që drejtësia

të mbetet nën kontrollin e tyre për më tej.

Lu humbi betejën e kauzës, humbi besimin e opozitës dhe qytetarëve, por do humbë edhe Ramën e Soros. Lu mbetet një mësim për opozitën e politikën në tërësi. Ambasadorët vijnë dhe ikin, Shqipëria mbetet këtu me halle të shtuara shumë, të cilat kërkojnë zgjidhje pikë së pari nga ne të gjithë.

**Vitin e ardhshëm zhvillohen zgjedhjet lokale ndërkohë që PS-ja po shkon drejt zyrtarizimit të Erion Veliajt për një mandat të dytë. Ndërkohë nga opozita flitet se më i mundshmi përballë tij është emri i Jorida Tabakut...**

Jorida Tabaku është personazh në rritje në politiken shqiptare. Ka personalitet, dinjitet, eksperiencë dhe lidhje të forta me kryeqytetin. Opozita ka mjaft emra dinjitoz për Tiranën: Klajda Gjoshja, kandidatë potenciale dhe politikane karriere, Dashamir Shehi, politikan popullor, manaxher brilant, i dashur dhe babaxhan për tiranasit, mediatik dhe karizmatik. Nuk duhet ta mendojmë të vështirë përballjen e Tiranës; demagogjia e Veliajt, konsumi moral dhe manaxherial, ndëshkimi për keqkëqeruesin lokalë e qendrorë, e bëjnë të lehtë fitoren e kandidatit të opozitës së bashkuar.

## EMIGRANTËT MBËSHTETJA

PD, Shehu: Italinë mund ta ndihmojmë jo duke i marrë 20 refugjatë, por duke luftuar kanabisin

# Shehaj: Për pushtet qeveritarët blejnë favoret e ndërkombëtarëve

Deputeti i PD tregon rastin personal si emigrant

Valentina Madani

Në Itali mbërrinë qindra emigrantë nga Afrika, ndaj vendi fqinj kërkon mbështetje nga shtetet e tjera. Shqipëria është ofruar për të pranuar 20 emigrantë. Ideja mbështetet edhe nga deputeti i opozitës, Agron Shehaj, i cili e lidh këtë mbështetje edhe historinë e jetës së tij si emigrant. Shehaj shkruan në 'Facebook' se në kohën kur ishte vetë emigrant, të gjithë të tjerët si ai ishin të trembur se Italia mund të vendoste që të mos mbante. Sipas tij, nëse shqiptarët e arritur në Itali do të largoheshin drejt një vendi tjetër po aq të varfër, do ndiheshim të përdorur. Ndërkohë ai e quan për propagandë të qeverisë, faktin që kjo pranoi të marrë 20 emigrantë nga Italia. "Pak gjëra janë më të neveritshme se qeveria shqiptare që bën për propagandë në kurriz të emigrantëve. Kam qenë vetë emigrant, i ikur me anije, pikërisht në vitin '91. Endëronim lirinë dhe Perëndimin dhe ishim të gjithë të trembur se Italia mund të vendoste të mos na mbante. Nëse në ato momente qeveria e një vendi tjetër, po aq të varfër sa Shqipëria, do kërkonte të përfitonte dhe do propozojë si alternativë e Italisë për të na marrë, do ndiheshim të përdorur dhe të indinjuar. Këta pushtetarë mendojnë vetëm se si të blejnë favoret e ndërkombëtarëve për të mbajtur pushtetin. Uroj që këta emigrantë t'ia dalin të realizojnë ëndrrën e tyre në Perëndim dhe mos të kenë fatin e keq dhe të përdoren...", shkruan z. Shehaj në 'Facebook'. Shqipëria do të ndihmojë Italinë në zgjidhjen e situatës së krijuar nga bllokimi i 150 emigrantëve të anijes "Diciotti" e bllokuar prej ditësh në portin e Katanas duke u ofruar të strehojë një pjesë prej tyre. Po dje përmes një postimi në 'Facebook', deputeti i PD, Tritan Shehu shprehet se qeveria po bën propagandë, pasi mirënjohja ndaj Italisë nuk mund të shprehet duke strehuar 20 refugjatë, ndërsa shteti fqinj strehon dhjetëra mijëra. "Dhe "dashurinë" ndaj Italisë kërkon

### # GENT STRAZIMIRI

"Në pritje që Franca të përgjigjet: faleminderit për "favorin", por na jepni këta 20 eritreasit dhe hajde merrni këta 25.750 shqiptarët që keni dërguar deri me 24 gusht 2018, e që i keni ende këtu...", - shprehet deputeti i PD-së.

ta shprehë me 20 refugjatë, pa shpjeguar se perse në 5 vite nuk ka asnjë investim të ri italian në Shqipëri. Italinë në mund ta ndihmojmë jo duke i marrë 20 refugjatë, por duke luftuar kanabisin që na ka

kthyer në furnizuesin Europës, nëpërmjet Italisë kryesisht, duke mos u bërë "autostradë" e kokainës e heroïnës drejt Italisë, duke goditur krimin tonë të organizuar, që po i krijon kaq shumë prob-

leme Italisë fqinje etj. Qesharake kjo e vetëm një farsë e Rilindjes... gjithmonë në 3D edhe kjo", shprehet z. Shehu. Sipas tij: "Prej 24 orësh veçse trumbetohet marrja e 20 refugjatëve nga Italia, e deklaruar kjo nëpërmjet fanfarëve propagandistike. Vlerësimi për Italinë e pazëvendësueshme për ne duhet të shprehet duke cilësuar rolin e saj ashtu siç është ai ndaj nesh. " thelbësor" dhe jo duke e klasifikuar atë nëpërmjet katërkëndëshave idiotesk të diplomacisë së Rilindjes, si vetëm një "prezantuese e Shqipërisë në Mesdhe" dhe ndërkaq duke kthyer fytyrën nga Lindja".



### ABSURDI

Deputeti i PD, Luçiano Boçi denoncoi dje një rast absurd sipas tij, ku godina e shkollës së mesme në njësinë administrative Bradashesh të Elbasanit është dhënë me qira. Ai thotë se aty janë investuar gati 1.5 milionë euro dhe jepet me qira me çmimin qesharak 75 lekë. Sipas Boçit, vendimi është marrë në muajin korrik.



Deputeti i PD-së Agron Shehaj gjatë kohës kur ishte emigrant në Itali



### SALI BERISHA

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje letrën e një emigranteje shqiptare që ka nënën në Fier dhe shprehet se nuk po gjen të drejtën e saj për shtëpitë që ka në këtë qytet. "Shkoj dhe kërkoj sqarime dhe asnjë përgjigje vetëm përbuzje duke na thënë, rini rehat andej ku jetoni, hajde se keni të ardhura", i shkruan emigrantja Berishës.

## Denoncimi

### Zbardhet axhenda dhe temat e diskutimit

## 'Integrimi dhe ekonomia', liderët e Ballkanit dhe Hahn sot në Durrës

Një takim mes njuhëheqësve të vendeve të Ballkanit Perëndimor me temë "Integrimi i Ekonomisë Rajonale" është planifikuar të zhvillohet sot në Durrës. Në këtë takim pritet të jetë i pranishëm edhe Komisioneri për Zgjerimin në BE, Johannes Hahn. Në këtë takim do të diskutohet gjerësisht mbi integrimin ekonomik të vendeve të rajonit dhe mbi projektin e nisur tashmë për krijimin e një zone ekonomike të rajonit. Zona Ekonomike Rajonale e vendosur në Samitin e Triestes synon të sigurojë mundësi të reja si për bizneset ashtu dhe për qytetarët, si dhe do të forcojë zhvillimin dhe vendet e punës. Në njëftimin zyrtar Delegacioni i Bashkimit Europian në Shqipëri, shprehet se, "Hapat e tjerë konkrete përshijnë njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale, identifikimin dhe eliminimin e burokracisë dhe barrierave rregullatore që pengojnë tregtinë dhe investimet në rajon duke krijuar një dialog rajonal mbi transformimin



### INTEGRIMI

Në këtë takim do të diskutohet gjerësisht mbi integrimin ekonomik të vendeve të rajonit dhe mbi projektin e nisur tashmë për krijimin e një zone ekonomike të rajonit.

digjital, si dhe hapja e negociatave për një mekanizëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve". Samiti pritet të nisë në orën 10:00, ndërsa kryeministria ka zbardhur dhe disa nga temat e diskutimeve si dhe axhendën. Disa nga temat e diskutimit do të jenë: Një vizioni të përbashkët mbi Strategjinë e Integrimit europian; Zbatimi dhe Fuqizimi i Zonës Ekonomike Rajonale1; Marrëveshja Roaming; Fillimi i negociatave për marrëveshjet e njo-

hjes reciproke të kualifikimet akademike dhe profesionale. Programi i takimit nis në 09.40 me ardhjen e delegacioneve, në 09.50, fotoja familjare, 10.00 do të jetë fillimi i sesionit të Samitit, 12.15 do të jetë Konferenca për shtyp e kryeministrit Rama, Komisionerit Hahn dhe kryeministrit pjesëmarrës, fjala e kryeministrit Rama, fjala e Komisionerit Hahn dhe pyetjet për secilin kryeministër.



**Bledar Zotaj i dënuar më herët për trafik droge në Greqi**

**Kapen me 125 kg marijuanë në Igumenicë, arrestohen 2 të rinjtë shqiptarë**

Vijon trafiku ndërko mbëtar i drogës në kufirin greko-shqiptar. Në orët e para të mëngjesit të djeshëm forcat policore të Igumenicës kanë arrestuar dy persona, të cilët transportonin lëndë narkotike drejt shtetit Helene. Policia bën me dije se janë sekuestruar rreth 125 kg marijuanë. Mësohet se shqiptarët e arrestuar janë 24-vjeçari Andea Alia, lindur në Vlorë dhe 34-vjeçari Bledar Zotaj, lindur në Greskë. Ky i fundit rezultoi në shpallur në kërkim nga policia greke, pasi në 19 mars të vitit 2013 ishte arratisur nga burgu i Patras, ku vuante dënimin me 11 vite burg për trafik droge. Dy shqiptarët u arrestuan në fshatin Lepotokaria në Igumenicë. Ata e kishin paketuar lëndën narkotike të llojit marijuanë në 77 pako të sistemuar më pas në çanta krahu.



Droga e sekuestruar në Igumenicë

Burime konfidenciale nga policia e Igumenicës, bënë me dije se konkretisht sasia e sekuestruar është 124 kg 660 gram. Policia helene po punon për zbardhjen e rrugës që ka ndjekur lëndë

narkotike si dhe për identifikimin e personave të tjerë të përfshirë në rrjetin e trafikut të drogës. Prej fillimit të vitit e deri sot, në Igumenicë, Korfuz, Lefkadha, Kefalonia, Janinë, Athinë,

**DROGA**  
Policia bën me dije se janë sekuestruar rreth 125 kg marijuanë. Bëhet me dije se shqiptarët e arrestuar janë 24-vjeçari Andea Alia, lindur në Vlorë dhe 34-vjeçari Bledar Zotaj, lindur në Greskë. Ky i fundit rezultoi në shpallur në kërkim nga policia greke, pasi në 19 mars të vitit 2013 ishte arratisur nga burgu i Patras, ku vuante dënimin me 11 vite burg për trafik droge.

Selanik, Arte, Kostur, Grevena, Follorinë dhe Aleksandroupoli, policia greke ka sekuestruar rreth 7.7 tonë marijuanë që vinte nga Shqipëria.

Italia vlerëson vendimin, falënderon Shqipërinë, Irlandën dhe kishën katolike

**Zbarkojnë emigrantët e anijes "Diciotti", 20 prej tyre do të akomodohen në Shqipëri**

Zv/kryeministri Di Maio: Komb më europian se themeluesit e BE-së

Ina Allkanjari

Merr zgjidhje problemi për 140 emigrantët, të cilët ishin bllokuar prej disa ditësh pranë brigjeve siciliane në anijen "Diciotti". Pas marrëveshjes që autoritetet italiane arritën me qeverinë shqiptare, atë irlandeze dhe kishën katolike, ministri i Brendshëm i Italisë, Mateo Salvini ka lejuar emigrantët që të zbrisin nga anija në portin e Katanias. Sipas marrëveshjes, 20 emigrantë do të strehohen në Shqipëri, 20 të tjerë në Irlandë dhe pjesa tjetër rreth 100 do të mbahen nën kujdesin e kishës katolike dhe autoriteteve të Vatikanit. Ministri i Brendshëm italian, Salvini ka falënderuar Shqipërinë, Irlandën dhe Kishën katolike për vendimin për të pranuar emigrantët afrikanë. Salvini kishte refuzuar që të lejonte zbarkimin e emigrantëve deri në momentin që Bashkimi europian do të binte dakord që të merrte një pjesë të tyre duke thënë se nuk donte që këta njerëz të bëheshin barrë për popullin italian. Sipas rregullave të Bashkimit Europian, emigrantët duhet të kërkojnë azil pikërisht në vendin e parë të BE-së, por pjesa më e madhe e këtyre refugjatëve kanë si portë hyrëse Italinë dhe Greqinë duke bërë që

këto vende të përballen me numrin më të madh të refugjatëve. Ndërkohë një pjesë e mirë e vendeve të Bashkimit Europian nuk ka treguar vullkanin për të pranuar refugjatët. Ndërsa prokuroria e Agrigentos ka ngritur akuza penale për ministrin e Brendshëm Mateo Salvini, për urdhrin e dhënë për ndalimin e ankorimit në portet italiane të anijeve me refugjatë. Sipas prokurorëve, Salvini ka privuar në mënyrë të jashtëligjshme nga liria personale, refugjatët e shpëtuar nga mbytyja në ujërat e Mesdheut, nga anija "Diciotti". Vetë Salvini njoftoi se ishte vënë nën hetim nga prokurorët sicilianë për abuzim me pushtetin. "Të hetohem për mbrojtjen e të drejtave të italianëve është një turp", deklaroi Salvini përpara mbës-



tesëve të tij. Pas vendimit të Shqipërisë për të pranuar 20 emigrantë reagoi kryeministri italian Giuseppe Conte, i cili falënderoi veçanërisht Shqipërinë dhe dy autoritetet

e tjerë, përmes një postimi rrjetin social Facebook. Gjithashtu, reagim të menjëhershëm pati edhe nga zëvendës-kryeministri italian Luigi Di Maio. Njëpërmjet një postimi

**'CORRIERE DELLA SERA'**  
"Corriere della Sera" i ka kushtuar një shkrim gatishmërisë së Shqipërisë për të pritur 20 refugjatë. "Një vend me një sipërfaqe pak më të madhe se Sicilia, një popullsi që prek 2.9 milion banorë dhe me Prodhimin e Brendshëm Bruto në rritje me 3.8% në 2017, Shqipëria është një shtet ku po transferohen gjithnjë e më shumë njerëz".

në rrjetin e tij social, 'Facebook' ai shprehet se Shqipëria është shumë më Europë se sa shumë shtete që e kanë fundosur atë. "Pas katër ditësh arritëm të gjenin solidaritetin

dhe mbështetjen e shteteve si Shqipëria që kanë hapur procesin për të qenë pjesë e BE-së. Por, për mua është shumë më Europë se sa shumë shtete që e kanë themeluar Europën. Dhe i dha një shuplakë morale e politike këtyre europianëve hipokritë që thonë se duhet të ndihmojmë emigrantët, duhet të ndihmojmë Itali e pastaj na përplasim dyert në fytyrë", shkruan Luigi Di Maio. Ai i nje meritat dhe Irlandës për ndihmën në marrjen e disa prej emigrantëve në anijen e bllokuar nga roja bregdetare italiane, si dhe Kishës, që siç shprehet, "na ka ndihmuar në këto situata". Italia ka ashpërsuar politikat për emigrantët, kryesisht nga vendet afrikane që hyjnë në territorin e saj përmes ujërave të Mesdheut.

**SHPALLJE ANKANDI**  
Zyra Perbarimore "E.G Bailiff Service" me përbarues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 14.09.2018 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i III për shitjen e pasurisë të paluajtshme Trulli me sipërfaqe 24,405.50 m<sup>2</sup> e ndodhur në rruën "Ali Shëfqeti", Tiranë me Nr.pasurie.9/609, Volumi.20, Faqe.6, në pronësi të Shoqërisë BAJ- CONSTRUCTION sh.p.k me vlerë fillestare në ankand 307.509 (Treqind e shtatë mijë e pesëqind e nente) EURO  
Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

Shitje me Ankand të dyte nga Studio Perbarimore L.D.C  
"Trulli + ndertese", me nr pasurie 31/12, ZK 3428, vol 5, fq 3 me sipërfaqe totale trulli 1.837 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndertese 280.6 m<sup>2</sup> me adrese fshati Shtoj i Ri, Shkoder. Regjistruar ne Z.V.R.P.P Shkoder ne emer te Zako Spaso Ajkovic . Çmimi fillestar per shitje eshte 15.680.000 Leke.  
Data e shpalljes 26.07.2018  
Data e zhvillimit 30.08.2018 deri ne oren 16.00  
Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Perbarimore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND  
ZYRA PERBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'  
Pasuria nr. 3/438+2-53, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 36, FAQE 37, SIPERFAQE 103 M2, ZONA KADASTRALE 8380, TIRANE, NE PRONESI TE Z. ALBAN QEMAL BALA.  
ÇMIMI 8.700.000 LEKË . Data e zhvillimit të ankandit do të jetë 24.09.2018  
CEL. 0684026666 ; 0693262866.

48-vjeçari i dënuar ne Itali për trafik kokaine, qëndroi 5 ditë i arrestuar në Igumenicë

# Krimet e Rënda nisin hetimet për pasurinë e Edmond Begos

*Në filtër të gjitha pronat dhe llogaritë bankare të biznesmenit*

Prokuroria e Krimeve të Rënda nis veri fikimin e pasurisë së biznesmenit Edmond Bego. Zyrtarë të këtij institucioni bëjnë me dije se do të kryejnë verifikime në kuadër të ligjit "Antimafia", për shkak se biznesmeni rezultoi i dënuar nga drejtësia italiane për trafik kokaine dhe heroine. Ligji antimafia parashikon se në rastet kur subjekti është dënuar për krim të organizuar, krahas tij nën hetim vihen edhe personat e bashkëlidhur me të. Për Begon kjo është hera e tretë që do të kalojnë në filtër të gjitha pronat e tij, nga llogaritë bankare deri në pronat e paluajtshme në bazë të ligjit antimafia. Përgjatë ditëve të fundit Partia Demokratike ka vënë nën akuzë kryetarin e grupit parlamentar socialist, Taulant Ballën si mbështetës politik i biznesmenit. Balla i ka hedhur poshtë akuzat, por nuk ka mohuar njohjen familjare me biznesmenin.

## NDALIMI I BIZNESMENIT

48-vjeçari Edmond Bego i dënuar në Itali për trafik droge dhe pjesëmarrje në organizatë kriminale u vu në fokusin e akuzave të opozitës pas ndalimit të tij disa ditë nga autoritetet greke të Igumenicës kur po kthehej nga pushimet me familjen në Korfuz.

Biznesmeni u lirua pas përgjigjes që pritej nga Interpol Roma drejt Interpol Athinës ku thuhet se ndaj Begos nuk ka asnjë çështje të hapur dhe nuk ka dënim për të shlyer në vendin fqinj për akuzën e trafikut të drogës. Kujtojmë se gjatë ndalimit nga policia greke, 48-vjeçari kishte deklaruar se i kishte shlyer detyrimet e tij me drejtë-



Biznesmeni Edmond Bego

## HETIMI

Prokuroria e Krimeve të Rënda ka vendosur të nisë një hetim mbi pasurinë e biznesmenit Edmond Bego. Zyrtarë të këtij institucioni bëjnë me dije se do të kryejnë verifikime në kuadër të ligjit "Antimafia", për shkak se biznesmeni rezultoi i dënuar nga drejtësia italiane për trafik kokaine dhe heroine. Ligji antimafia parashikon se në rastet kur subjekti është dënuar për krim të organizuar, krahas tij nën hetim vihen edhe personat e bashkëlidhur me të.

inë dhe se po e arrestonin padrejtësisht. Ndërkohë Ardian Leka, avokati i Edmond Begos u shpreh në lidhje me këtë çështje se pas vitit 2009 emri i klientit të tij nuk ka ekzistuar në sistem dhe se dyshon se ndalimi nga Greqia ka qenë i qëllimshëm e jo një gabim. Gjithashtu, Leka tregoi se Bego është liruar dhe është nisur drejt Shqipërisë. "Edmond Bego u

lirua, është nisur drejt Shqipërisë. Përgjigja erdhi mbrëmë nga Interpol Roma. Prokuroria e Apelit nxori urdhrin e lirimit. Bego s'ka pasur çështje të hapur pas 2009. Në 2009 Bego është arrestuar nga shteti shqiptar. Ai i përfundoi detyrimet e tij në 2014. Është njësoj si me radhët e gjata në doganë. Ky emër në sistem nuk ka ekzistuar asnjëherë nga viti 2009

e në vazhdim. Kjo është situata. Këtë gjë e kemi peshqesh nga shteti grek", deklaroi avokati. Më tej avokati theksoi se do të konsultohet me kolegët grekë dhe më pas do nis procedurat për ankimim. "Kjo është një procedurë që do fillojë në shtetin grek nga avokatët grekë. Pas konsultimit në Shqipëri do fillojmë procedurën. Mendojmë se është një gjë me

## DËNIMI

Edmond Bego, pronar i disa bizneseve në Shqipëri, është dënuar në vitin 2008 nga gjykata e Apelit e Torinos me 21 vite heqje lirie. Ai u arrestua në vendin tonë në vitin 2009 dhe në 15 shtator 2010, Gjykata e Lartë ia konvertoi dënimin nga 21 vite burg që e kishte dënuar drejtësia italiane, në 4 vite e 4 muaj.

territorin italian ka hyrë 3 herë në vitin 2017, dhe në datë 13 korrik në vitin 2018. Bego në datë 8 gusht 2018 ka dalë nga PKK Qafë Botë drejt territorit grek, siç ka bërë edhe më herët në vitet 2014, 2015, 2016, 2017 dhe 2018, në disa raste në mënyrë të përsëritur. Pra, për këtë shtetas nuk ka pasur asnjë urdhrë tjetër ndalimi ndërkombëtar përveç urdhrin të ndalimit të ekzekutuar nga Policia e Shtetit në vitin 2009, që do të vinte në lëvizje Interpol Tiranën dhe Policinë e Shtetit, apo ndonjë kërkesë nga autoritetet italiane dhe misionet e tyre policore në Tiranë, ndryshe nga sa u deklarua nga subjekti politik Partia Demokratike", thuhet në reagimin e Policisë së Shtetit. Edmond Bego, pronar i disa bizneseve në Shtet dhe cila theksoi se pas verifikimeve, rezultoi se shtetasi Edmond Bego nuk është në kërkim kombëtar dhe ndërkombëtar nga autoritetet policore shqiptare për llogari të ndonjë shteti tjetër. Gjithashtu, nga verifikimet e kryera në sistemin TIMS, Bego ka dalje dhe hyrje nga territori shqiptar nga vitet 2013 deri në vitin 2018. "Nga verifikimet e kryera në sistemin TIMS, shtetasi në fjalë ka dalje dhe hyrje nga territori shqiptar nga vitet 2013 deri në vitin 2018, edhe drejt Italisë. Ai në

dashje, jo gabim por ky është mendimi im", tha avokati i Edmond Begos. Në lidhje me këtë çështje pati reagim edhe nga Policia e Shtetit e cila theksoi se pas verifikimeve, rezultoi se shtetasi Edmond Bego nuk është në kërkim kombëtar dhe ndërkombëtar nga autoritetet policore shqiptare për llogari të ndonjë shteti tjetër. Gjithashtu, nga verifikimet e kryera në sistemin TIMS, Bego ka dalje dhe hyrje nga territori shqiptar nga vitet 2013 deri në vitin 2018. "Nga verifikimet e kryera në sistemin TIMS, shtetasi në fjalë ka dalje dhe hyrje nga territori shqiptar nga vitet 2013 deri në vitin 2018, edhe drejt Italisë. Ai në

## Aksident në Fier, makina përplas për vdekje dy kushërinjtë.

Rrugët e Shqipërisë janë përgjakur mbrëmjen e djeshme, ku një aksident i ka marrë jetën dy kushërinjve. Ngjarja e rëndë ka ndodhur në fshatin Arapaj të Fierit. Burime për "Gazetën Shqiptare" bëjnë të ditur se një makinë ka përplasar dy këmbësorë, të cilët kanë ndërruar jetë. Viktimat janë Amarildo Dogani dhe Festim Dogani, kushërinj me njëri-tjetrin. Sipas të dhënave paraprake, ata ishin duke ecur në anë të rrugës kur janë përplasar për vdekje mjeti. Dysho-



Foto ilustruese

het se drejtuesi i mjetit që ka përplasar dy viktimat ka qenë me shpejtësi. Ndërkohë që drejtuesi i makinës që shkaktoi aksidentin e rëndë

është ndaluar nga policia. Grupi hetimor ka nisur hetimet për zbardhjen e plotë të shkaqeve dhe motiveve të ngjarjes.

United Nations Development Programme

VACANCY ANNOUNCEMENT

The United Nations Development Programme in Albania is looking for qualified candidates who could fill the following vacancies:

<b>Posts Titles:</b>	1- National Consultant – support to employment of Vulnerable Youth and Northern Albania
Women in	2-National Consultant – Socio-economic assessment for Vulnerable Youth in Kukes
in Shkodra	3-National Consultant – Socio-economic assessment for Vulnerable Youth in Shkodra
in Dibra	4-National Consultant – Socio-economic assessment for Vulnerable Youth in Dibra

**Type of Contract:** Individual Contract

**Project:** Support to Employment and Social Services for Vulnerable Youth and Women in Northern Albania

**Duty Station:** Tirana, Albania

**Deadline for Application:** September 5, 2018

**Job Description:** <http://al.undp.org>

Qualified and interested candidates are requested to apply online via UNDP Albania website: <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>. Interested applicants are advised to carefully study all sections of this ToRs and ensure that they meet the general requirements as well as specific qualifications described. Incomplete applications will not be considered. Please make sure you have provided all requested materials. Qualified women and members of social minorities are encouraged to apply.

Aksident në Fier, makina përplas për vdekje dy kushërinjtë.

Rrugët e Shqipërisë janë përgjakur mbrëmjen e djeshme, ku një aksident i ka marrë jetën dy kushërinjve. Ngjarja e rëndë ka ndodhur në fshatin Arapaj të Fierit. Burime për "Gazetën Shqiptare" bëjnë të ditur se një makinë ka përplasar dy këmbësorë, të cilët kanë ndërruar jetë. Viktimat janë Amarildo Dogani dhe Festim Dogani, kushërinj me njëri-tjetrin. Sipas të dhënave paraprake, ata ishin duke ecur në anë të rrugës kur janë përplasar për vdekje mjeti. Dysho-

është ndaluar nga policia. Grupi hetimor ka nisur hetimet për zbardhjen e plotë të shkaqeve dhe motiveve të ngjarjes.

## KOLEGJI UNIVERSITAR "LUARASI" APLIKIMET PËR 2018-2019

"Luarasi jep bursa merite dhe nevojë, kriteret. Mbi 80% e të diplomuarve janë punësuar"

# Rreth 1200 maturantë përzgjedhin "Luarasin", rritet me 256% numri i aplikimeve

Rektori Ethem Ruka: Një ndër 4 universitetet më të mira në vend

Voltiza Duro

Rreth 1200 maturantë në mbarë vendin kanë përzgjedhur të vazhdojnë studimet e larta në universitetin 'Luarasi' për vitin e ri akademik 2018-2019. Rezultatet e publikuara nga Ministria e Arsimit tregojnë një rritje të dukshme prej 256% të numrit të aplikimeve drejt këtij universiteti, krahasuar me një vit më parë. Rektori i "Luarasit" prof.dr. Ethem Ruka tregon se falë standardeve të larta të mësimdhënies dhe kredibilitetit në treg, ky institucion i arsimit të lartë po fiton çdo ditë e më shumë interesin e të rinjve. Ruka shton se fushata e këshillimit të karrierës për rreth 25 mijë maturantë është një tjetër faktor që ka ndikuar në rritjen e numrit të aplikimeve të të rinjve në 'Luarasi'. Sipas raportit britanik, Kolegji Universitar "Luarasi" i akredituar për gjashtë vite akademike, rezultoni të jetë një nga 4 institucionet më të mira të arsimit të lartë në vend. Rektori Ethem Ruka e vlerësor certifikatën 6-vjeçare të akreditimit si një nga pikat më të forta të këtij universiteti. Edhe këtë vit të ri akademik, Kolegji Universitar 'Luarasi' do të japë bursa për maturantët ekselentë, por pa harruar edhe nxënësit në kushte të vështira ekonomike. Vetë studentët shprehin tejet të kënaqur që kanë përzgjedhur 'Luarasin' si rrugën e tyre të sigurt drejt së ardhmes.

**Sa është numri i maturantëve në rang vendi që kanë përzgjedhur të ndjekin studimet në Kolegjin Universitar "Luarasi" për vitin e ri akademik 2018-2019?**

Kjo është një pyetje vërtet interesante. Praktikisht sistemi i Ministrisë së Arsimit u bë disponibël për shkollat e larta ku u njohën rezultatet e përzgjedhjes së maturantëve të këtij viti shkollor. Në kuadër të këshillimit të karrierës, Luarasi kontaktoi mbi 25 mijë maturantë në të gjithë vendin, ishte një punë shumë serioze, gjithëpërfshirëse ku ne kemi shkuar shkollë më shkollë e fshat më fshat, nga Saranda deri në Shishtavec të Kukësit. Jemi të kënaqur se 'Luarasin' sivjet e kanë zgjedhur rreth 1200 maturantë, çka përbën një rritje të konsiderueshme në raport me vitin e kaluar. Shpresoj që kjo përzgjedhje të korrelojë edhe me regjistrimet që do të bëhen në ditët në vijim.

Numri i aplikimeve ka pësuar një rritje me mbi 250% krahasuar me 2017-ën.

**Pse mendoni se ka ardhur në rritje numri i aplikimeve për 'Luarasin'?**

**Cfarë ofron ky institucion i arsimit të lartë për studentët?**

Sigurisht ka shumë faktorë që kanë ndikuar në rritjen e kredibilitetit të Kolegjit Universitar 'Luarasi', ka dhe faktorë që dalin jashtë universitetit. Dua të përmend të paktën dy faktorë që lidhen me Ministrinë e Arsimit të cilën dua ta falënderoj pasi na krijoi mundësinë për këshillimin e karrierës, ku drejtoritë rajonale të arsimit, zyrtarë arsimore, mësuesit, nxënësit na krijuan një mjedis fantastik për të bashkëbiseduar dhe për të shpjeguar se çfarë përfaqëson Luarasi në raport me institucionet e tjera. Këshillimi i karrierës këtë vit u karakterizua nga një tregues që nuk ka ekzistuar vitet e kaluara: certifikimi i shkollave të larta, pra rezultatet e akreditimit. 'Luarasi' për shkak të performancës së vet, është vlerësuar maksimalisht dhe rezultoni që të jetë një ndër katër shkollat e larta më të mira në vend. Kjo certifikatë akreditimi shënon 6 vite, dhe ky është një tregues fantastik, një armë e fortë nëpërmjet së cilës i shpjegojmë maturantëve se ata duhet të bëjnë zgjedhjen e duhur për tu arsimuar sa më mirë e për të marrë një diplomë të vlefshme.

**Cilat do të jenë risitë që do të ofrojë universiteti "Luarasi" për vitin e ri akademik 2018-2019?**

Universiteti "Luarasi" ka ardhur duke u rritur e mund të them me bindje të plotë se kjo rritje sasiore dhe cilësore është gati 40%, sepse janë hapur disa programe studimi, janë bërë funksionale rreth 7 mastera të rinj, është hapur fakulteti i ri i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit dhe sigurisht ky i fundit erdhi në momentin e duhur. Kjo pasi teknologjitë e informacionit janë jashtëzakonisht të rëndësishme në shoqërinë e sotme, ato e kanë bërë plane-



Rektori i Kolegjit Universitar "Luarasi" z.Ethem Ruka

### KLEVJA CITOZI "PUNËSIM I SIGURT"

Të thuash a je e kënaqur, për mua është pak! Luarasi është pjesë e 'Hysenbelliu Group', një prej grupeve më të fuqishme të momentit, dhe unë u bera në 9 maj tashmë që krahas studimit, punoj në një nga kompanitë në zyrën e financës të 'Hysenbelliu' shpk. Ndihej shumë e privilegjuar, që ky institucion më ka përgatitur për tregun e punës.



### KRISTI ÇAKA "PËRZGJEDH 'LUARASIN' EDHE PËR MASTER"

Unë përfundova ciklin e parë të studimeve bachelor në universitetin Luarasi dhe duke vlerësuar përgatitjen dhe profesionalizmin e lartë të stafit akademik vendosa që të vazhdoj dhe ciklin e studimeve master pranë Luarasit. Është një institucion i arsimit të lartë me standarde europiane, ndihem e kënaqur që jam pjesë e "Luarasi-t".



### XHESIKA PICARI "ZGJEDHJA E DUHUR"

Në këtë institucion gjeta jo vetëm ngrohtësinë dhe mikpritjen e pedagogëve por edhe atë të studentëve më të vjetër. Gjeta motivim edhe forcë për të mbështetur dhe realizuar idetë e mia në aktivitetet të ndryshme, falë mikpritjes së tyre. Nëse do të krahasoja zgjedhjet e mia, definitivisht 'Luarasi' është zgjedhja e duhur.



tin më të vogël e kanë rritur kontaktin mes njerëzve, i kanë shërbyer globalizimit e i kanë bërë gjërat më të lehta. Këtë ne ia kemi shpjeguar maturantëve, ata na kanë besuar dhe si pasojë disa qindra maturantë kanë zgjedhur këtë fakultet pranë 'Luarasit'.  
**Edhe këtë vit universiteti "Luarasi" do të japë bursa për të rinjtë që zgjedhin të vazhdojnë rrugëtimin e**

**tyre akademik pranë këtij institucioni të arsimit të lartë. Cilat janë kriteret për të përfutur bursa për të gjithë të interesuarit?**

Ne jemi prezanuar para maturantëve shqiptarë me një paketë shumë interesante. Paketat kanë qenë stimuluese, nxitëse për të rinjtë, por besoj që nxitësi kryesor është rezultati e ne jemi të interesuar të kemi

studentë sa më të mirë. Është fat i madh që ata që kanë përzgjedhur 'Luarasin' këtë vit janë me rezultate shumë, shumë të mira. Nxënësit me nota 9 dhe 10, janë përfutuesit e parë të bursave në këtë universitet. Ka disa dhjetëra studentë që e përfutjnë këtë bursë merite, ashtu siç ka bursa që jepen për studentët me probleme sociale e favorizohen për këtë pjesë. Ne nx-

isim edhe studentët që janë të dalluar në fusha të caktuara si në art, sport e kemi mjaft të rinj të tillë që përfutjnë një bursë ku detyrimet e tyre ndaj universitetit janë zero lekë për shkak të kontributit të shkëlqyer që japin në fusha të tjera.

**Në bazë të statistikave, sa i sigurtë është punësimi pas përfundimit të studimeve në "Luarasi"? A mund të themi se diploma e përfutur nga ky institucion i arsimit të lartë, është një pasaportë e sigurt drejt tregut të punës?**

Normalisht që po! Ne i ndjekim studentët edhe pas përfundimit të shkollës, pasi nuk punojmë vetëm për të sjellë studentët. Shkalla e punësimit të studentëve që disponojnë një diplomë nga universiteti "Luarasi" ka qenë e lartë, e kënaqshme ku gati 80% e atyre që përfundojnë studimet të ne gjejmë punë në një periudhë gati 6 muajore pasi marrin diplomën. Kësaj i shërbejnë edhe një sërë praktikash që ne ndjekim gjatë vitit mësimor falë ku studentët ushtrojnë praktikën, krijojnë një kredibilitet.

**Cila është ftesa juaj për të gjithë maturantët shqiptarë që do të regjistrohen brenda katër ditëve në universitete?**

Jemi në fazën ku maturantët do të fillojnë regjistrimet në universitete. Dua të them se ato fjalë që i kemi thënë maturantëve, të mos kenë asnjë dyshim që janë të gjitha realitet për universitetin "Luarasi". Ky universitet ka një staf të shkëlqyer, një administratë mjaft profesionale, është në vendin më të preferuar të Tiranës, me një infrastrukturë që nuk e ka asnjë universitet tjetër, ku nuk mungon absolutisht asgjë. Studentët mësojnë të ne, bëhen më të ditur, ushtrohen praktikisht. Do t'i ftoja studentët shqiptarë që kanë zgjedhur 'Luarasin' që pa asnjë hezitim të vijnë e të regjistrohen pasi investimi që do bëjnë këtu, do tu kthehet në një diplomë me vlerë për të ardhmen e tyre.

## INTERVISTA SPECIALE (PJESA E PARË)

Intervista / Dëshmia e rrallë e 98-vjeçares Marte Biba Doçi, e motra e "Heroit të Popullit", Bardhok Biba, e cila sfidoi regjimin komunist duke mos pranuar të futej në kooperativë në Laç të Kurbinit ku banon që nga periudha e Monarkisë së Zogut

# "Unë motra e Bardhok Bibës që vuajta burgjeve bashkë me katër djemtë e mi"

Rrëfimi: "Si e kundërshtova dhe e godita me shpullë kryetarin e Këshillit dhe shefin e policisë Laçit, Reshat Gjyli, që erdhën në shtëpi për të më futur forcërisht në kooperativë"



Enver Hoxha së bashku me prindërit e Bardhok Bibës pak pas vrasjes së tij në Mirditë.-1949

zgjodhën deputet dhe i pari i Partisë së vet ktu n'Mirditë.

**Familja juaj ishte nga dera e Kapidanit të Oroshit, pra kushërinj me Gjonmarkajt, si e priten ata faktin se Bardhoku u lidh me Partinë Komuniste?**

Kapidanit (Gjon Marka Gjonit) i erdh keq se Bardhok Biba u lidh me Partinë Komuniste.

**Si e kujton atë ditë të vrasjes së vëllait tuaj, Bardhokut?**

Vrasjen, po, e kujtoj shumë mirë. I erdh një lajm me dalë në Qafë të Valmerit, me mbledhun shok e shoqe me i dërgu në punë, në Malë të Korçës më duket. I thotë kjo e shoqja, Mrika, jam duke larë rrobat. Kishte nxjerr një kazan të madh dhe kështu punësh... I thotë mblidhi rrobat dhe qiti mbrenda se më ka ardh një lajm, se duhet të jem në filan vënd patjetër.

Kurse Mrika ia kthej: "Pash-zotin or Bardhok, i thotë Mrika, na ndave me këtë plak dhe me këtë vajzë, mos..."

"S'jam duke të ndarë moj...", ia ktheu Bardhoku.

Po Mrika sikur ta paranjente dhe vazhdoi tuj e kundërshtu: "Përzotin jan duke të vra...Do të kallxoj një andërr i thotë..."Po Bardhoku s'e la me fol ma, çohu i tha...po shkoj...

**Pra, Bardhokun e njoftuan se duhet të shkonte për një punë partie...?**

Po, po, ashtu i tha dhe Mrikës: "Më ka ardh një lajm se duhet me mbledh njerz e me i dërgu në Malë të Korçës", ku u bante panxhari, me mbledh puntori. I thanë në telefon: "Bardhok, hajde vetë, se nuk na mblidhen njerzit me i dërgu kund". U çua dhe shkoj vetë në Qafë të Valmirit, me u sgaru me njerzit...! Ju shkoj në gojë..., ku kishin ardhur diversantat, ra me parashutë kushedi se sa ditë e kohë përpara...!

Nga Dashnor Kaloçi

Duke qenë një familje dëshmori, apo si motra e Heroit të Popullit, Bardhok Biba, mund dhe do të kishte përfituar shumë nga ai regjim, si shumë familje të tjera kudo nëpër Shqipëri dhe më e pakta do kishte kaluar një jetë të paqetë pa shumë andralla. Madje jo vetëm kaq, por po t'i kishte bërë sado pak "duva" atij pushteti, do kishte përfituar shumë e shumë lavdi e privilegje, po të kemi parasysh edhe faktin se; personalisht Enver Hoxha do të shkonte disa herë për vizitë në shtëpinë e Bardhok Bibës në Rrëshen, do të çonte djalin e tij me nusen (Ilirin me Teutën) te dasma e Marie Bibës, (madje edhe me dhurata), të cilën e ftonte edhe në Tiranë në raste festash, përvjetorësh, apo Kongrese, si p.sh. në Kongresin e 8-të të PPSH-së, ku në Pallatin e Brigadave, vetë Enveri do t'ia merrte valles me Marien, duke iu thënë me mburrje delegatëve të tjerë: "E kam vazhën e shokut tim të luftës"! Gjëra të cilat "shoku Enver", nuk i kishte bërë kurrë me asnjë prej figurave kryesore të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare, dhe emblematike të propagandës e historiografisë së regjimit komunist, si p.sh. Qemal Stafa, Vojo Kushi, Vasil Shanto, Mistho Mame, Alqi Kondi, Vasil Laçi etj. etj., shokë e bashkëpunëtorë të afërt të tij që i kishin familjet në Tiranë?! Por Marte Biba Doçi duket se as ka dashur t'ia dijë fare për këto gjëra dhe me vetëdije të plotë ajo dhe familja e saj nuk pranoi asgjë nga ai pushtet, asnjë nga privilegjet që u bëheshin familjeve të dëshmorëve,



Marte Biba Doçi

apo e Heronjve të Popullit, siç ishte i vëllai i saj, Bardhok Biba?! Madje ajo zgjodhi të kundërtën, duke e kundërshtuar politikën e atij regji bash në një nga pikat kryesore të reformave me të cilën mburrej ai regjim, te "kolektivizimi i fshatarësisë", pasi Martja me familje e saj nuk pranuan kurrë që të hynin në kooperativë. Gjë për të cilën do të kishin pasoja të rënda, duke përfunduar familjarisht burgjeve dhe internimeve të atij regjimi për vite me radhë. Dhe si për t'i qëndruar konseguente deri në fund bindjeve dhe traditës së familjes të saj, ashtu siç i takonte një "bijë që rridhte nga familja e Kapidanit të Mirditës, Gjon Markagjonit", Martja shkoi e vetëdijshme në burg, duke mos pranuar të firmoste në gjyq një dokument ku thuhej se "ishte e dalme mëndsh", gjë e cila nuk qëndronte dhe ishte një kompromis që pushteti i asaj kohe kërkonte ta bënte jo për të shpëtuar Marten, por për

veten, që të mos diskreditohej nga "njerëzit e vet", siç konsiderohej dhe ishte familja e Bardhok Bibës. Lidhur me këto dhe të tjera ngjarje dhe fakte nga jeta e saj, 98-vjeçarja Marte Biba Doçi me një memorie brilante dhe shëndet fizik si jo më mirë, na i rrëfen për herë të parë dhe ekskluzivisht për "Gazeta Shqiptare", intervistë të cilën po e publikojmë gjithashtu, në dialektin e saj.

**Znj. Marte, si e kujtoni Bardhokun e vogël?**

Bardhokun po e mbaj, ishte djalë i shoqneueshëm, djal mos me tanu (ngacmu) njeri, djal i dashtun me t'gjith, me heq kafshatën e gojës veç me e hangërr shoqi, djal që s'fliste kush një fjalë të keqe për të.

**Ku u shkollua Bardhoku?**

Në Konvikt të Oroshit dhe në Shkodër. Me halle se nuk kishim asnjëri në punë, se atëherë nuk kishim asnjë përkrahje....

**Sa vetë bëheshit në familjen tuaj në atë kohë?**

Baba, Biba, nana më vdiq, vëllaznit ishin të vogël, pas meje të dy, motra tjetër.... Bardhokut i patën vra vëllanë, Markun, 18 vjeç. I patën djeg shtëpiat tre katëshe, të Kol Marka Kolës dhe dy katëshe të Bib Marka Kolës, të axhës dhe të babës dhe vranë Marka Bibën, dorzohu, dorzohu dhe s'u dorzu. E kan pas rrethu me 50 burra dhe s'u dorzu, për arsye se do ta vritshin herën e fundit.

**Po Bardhoku ku ishte në atë kohë?**

Bardhok Biba ishte në mal dhe u lidh me një parti andej nga Bashkimi Sovjetik thanë.... edhe erdh me Partinë Komuniste. Atëhere kur ky u lidh me Partinë Komuniste, thanë humbi Bardhok Biba.... s'dijshim se ku është. Kishte pas shkue në Bashkimin Sovjetik me shokë, kështu thojshin atëhere. Erdh atëhere me shokë dhe kta shokt e vet e



Bardhok Biba





**Kush kishte shkuar përpara në Qafën e Valmerit?**

Kishte shkue Nue Pjetri, Ndue Pjetër Gjokmarku me shokë, ishte në Shkodër ai, bënte mbledhje me diversantët...!

**A e dinte Bardhoku se ata të Komitetit të Maleve i kishin vënë pritat...?**

Posi s'e dinte..., e dinte që ishin vu pritat, ishte thyer kufiri, kishin dal natën pa u pa, kishin forcue forcat, me u vra Bardhoku, o me vdek, o me u vra. Poo, Bardhoku e dinte për ata, i çuan fjalë, kishte ardh nga Italia, Ndue Pjetër Gjokmarku, kushëri i dytë, a e kupton, i jati me babën tim, babat vëllazën.

**Po pse u nis Bardhoku për atje...kur e dinte se i kishin vënë pritat?**

Po Bardhoku nuk mendonte se; më vret Mirdita mue, Bardhokun e dojshin shumë, pleqt e plakat, e dojshin, i tha, Sulejman Manoku, (nuk e di a është gjall apo vdek), i tha: "Bardhok, mos u nis"... e kjo e shoqja, Mrika, po kështu i tha, mos u nis. Po Bardhoku u nis e shkoi se i çuan fjalë, hajde i thonë, me mbledh puntorinë me i dërgu në punë...!

**Dhe Bardhoku shkoi bashkë me Mrikën...?**

Poo bashkë shkun..., por Mrika iu lut prap: "Pash-zotin mos më ndaj me këtë fëmij"... kishte Marien të vogël.

"S'jam duke të ndarë moj, edhe me vdek unë, shokët e Partis së Punës, patjetër, të vënë dorë dhe nuk të lënë me vdek për një kafshat bukë...".

"Pash zotin mos më ço n'atë ditë...", ia ktheu Mrika.

"Hajt, i thotë Bardhoku, "merre Marien para gjunjësh", dhe hipi vetë në kalë, vuri vajzën, Marien, në kalë edhe të shoqen Mrikën para dhe u nisën me shku për atje, ku këta përpara kishin shku në Qafën e Valmerit. Tuj ec... ranë në pritrë në



Babai i Bardhok Bibës

Qafë të Valmerit, Bardhoku ishte me nja shtatë a tetë vetë, vra Bardhokun, u bë rrëmuja e dynjasë...!

**A kenë qenë ju në varrimin e Bardhokut?**

Kur është varros Bardhok Biba..., posi s'kam qenë, e mbaj mënd, erdh gjeneral-lejtant Mehmet Shehu, erdh Gjin Mark Toma, erdhën 20 ushtarakë, edhe bënë një ceremoni..., dhe kur e lëshuan arkivolin në varr, bënë një batore pushkë, si Partia e Punës kur gjuante, ligj i shtetit...!

**Është thënë se babai i Bardhokut, Biba, i ka kërkuar Mehmet Shehut që të mos arrestonte dhe pushkatonte njerëz pa faj, pra ata që nuk kishin gisht në vrasjen e Bardhokut. A e kujtoni ju këtë gjë?**

Poo, si nuk e kujtoj. I tha baba Mehmet Shehut: "Faj e pa faj mos i merrni popullin, aman..., unë pa djal jam, e kam dal fare, zotin i tha, ç'farë din me ba vetë, këta do të bëjnë, pash-zotin faj e pa faj, mos e merrni popullin në qafë, që besa e zotit..."

**Si iu përgjigj Mehmeti?**

Mehmet Shehu i tha: "Do të vrasim 101 burra për Bardhok Bibën", ...përzotin s'jam duke e thënë unë, por përzotin kështu tha Mehmet Shehi, "s'e ka lënë shokun të gjallë", tha Mehmet Shehu për Bardhok Bibën, "101

burra do të vras..."

"Pash zotin" i tha baba, "faj e pafaj pash zotin në qafë njeri mos merr"...edhe ata kryen detyrën e vet...! Enver i katër i ka varë n'litër dhe dhjetë i ka pushkatue, e nëpër burgje...,plot, mos e pyt ç'a ba...!

**Po më pas kur bëheshin përvjetorë në nderim të Bardhokut u vinin nga udhëheqja e lartë e Tiranës dhe a ju thërrisnin juve si**



**familje?**

Kanë ardh, na kanë ftuar për drekë, motrën time në Rrëshen, (motra ime nuk ka djal as bijë, ka dalë fare), edhe vajzën e Bardhokut, Marien, edhe Gjon Marka Kol Markun, ky Bardhok Bibën e kishte më tepër se djalin dhe familjen mbarë...,edhe kështu vajt puna...

**Pas vrasjes së Bardhokut, ku keni banuar dhe punuar ju me familjen tuaj?**

Unë me burrin tim (Preng Doçi) e katër djemt, kemi banu në fshatin Laç të Kurbinut, ku të parët e fisit Doçi kan pa ardh herët, në kohë të Zogut, hik prej malit dhe ra n'fushë për jetë ma t'mir. Kemi qenë bashkë dhe me vëllaznit e burrit, Pjetrin dhe Gjonin e familjet e tyn, shtëpijat afër i kemi pas.

**Përse dhe si nisi konflikti tuaj me atë regjim ku kishte shërbyer në funksione të larta dhe vëllai juaj, Bardhoku?**

Unë me familjen time,

burrin dhe katër djemt, nuk kena pa nigjue me u fut në kooperativë, nuk donim me hi në kooperativë dhe na vinin tuj na u lut kta të partisë dhe t'pushtetit me na marrë me të mirë...

**Kush ju ka ardhur, e mbani mënd?**

Ka qenë ktu afër shtëpisë sonë, burgu te Uzina, (Burgu 305 me të burgosur politikë që ndërtuan Uzinën e Superfosfatit në Laç në vitet 1962-1967. Shënim ynë, D.K.) ishte komandant burgu, Sulejman Manoku, shok i Bardhokut qysh në Rrëshen. Erdhi këtu te ne bashkë me motrën e Pal Mëlyshit, e dërgun ata t'Partisë se nuk erdh vetë. "Mirserdhët", ju thamë ne, "mirsejgjetëm", na thanë ata. "Tash tre muaj kam dasht me ardh me u takue dhe s'mund ju gërita", hapi muhabetin i pari Sula: "Tash 15 vjet që është vra Bardhok Biba dhe nuk gjete rastin me ardh me pi kafe"? i tha burri jem, Prenga. Ngelën ata kur i tha ashtu.

**Si iu përgjigjën, çfarë tha Sulejman Manoku?**

Sula s'foli fare, uli kryt përdhe. Kurse e motra e Pal Mëlyshit, tha: "Paskemi ardh kot këtu", dhe u çuan dhe dulën pa buk, u çuan e dulën, shkoi ora 10 e natës, ikën e s'u panë ma ktu kurr....

**Po pas këtyre, a ju vinin të tjerë për t'ju lutur apo për t'ju bërë presin që të futeshit në kooperativë?**

Poo vëllaznit..., na çonin fjalë me ndonji ktu, por unë nuk pranojshim gjallë me hy në kooperativë...

**Kush ju vinte dhe çfarë ju thoshin, a i mban mënd?**

Posi se kujtoj... herë s'fundit herë ka ardh kryetari i Këshillit të fshatit Laç, Pashk N. me disa tjer nga prapa dhe me hi n'kooperativë na thoshin. Unë, me vllan e burrit, kishim pendën e qeve, mushkën dhe disa bagti të imta dhe punojshim tokën tonë, n'punë tonë. Edhe më thanë do hysh në kooperativë...,bre po, bre jo,

erdh...ky që ka qenë familje komunisti, Reshat Gjylja, (se di a është gjall a është vdek Reshat Gjylja), dhe i thashë: "Pash zotin o Reshat Gjylja, (flet për Reshat Gjylin, ish-shef Policie në Laç në fundin e viteve '60-të dhe fillimin e viteve '70-të. Shënim ynë, D.K.), pash-zotin m'u hiq qafe. Pash kryet e Naim Gjylbegut, (të vëllajt Hero i Popullit), e kokën e fëmijve, m'u hiq qafe, se jam një familje puntore që s'kam njeri në punë, jam një familje që s'i kam kurkujt borxh, m'u hiqni qafe..."

**Po ai si ju përgjigj?**

Ai..., hec, hec, dhe më lëshoi Kryetarin e Këshillit në shpinë, një Pashka N..... (është gjallë), ai erdh dhe më kapi për flokësh dhe u kapëm kështu..., unë i rashë me një shpullë dhe m'u hoq shamia e ra aty, ishin kooperativistët, ishin aty, 20-30 vetë u mblodhën....

**Çfarë i thatë ju pas kësaj, si reaguat?**

Heu thashë, o i madhi zot, jarabi fëmijët gjë mos ua gjettë, se fëmijët tuaj nuk janë pjesmarrës të hallit dhe të punës sime, se s'dinë gjë se i keni te shtëpia, por thashë, ata atje, zoti i madh i nxjerrtë fare, thash, me të madh dhe me të vogël, se jam para familje sime, kurkujt keq s'i kam bërë, fëmijët m'i kanë nxjerrë e përrjasht nga shkolla, jeni duke më trishitur në familje, s'u kam borxh, jam para familjes sime, para oborrit tim....

**Çfarë ndodhi pas këtij konflikti me kryetarin e Këshillit dhe shëfite e policisë?**

Ky Reshat Gjylji, i tha Pashka N..... kape mo..., dhe erdh e më kapi për flokësh ai, edhe unë i rashë fytyrës, (bën me dorë duke treguar se si e ka qëlluar me shpullë. Shënim ynë, D.K.), edhe ai tha: "Mbage mënd këtë shpullë". Heëë i thashë, erdh dhe më trishitove në familje ti, ç'farë borxhi të pata, jam te familja ime, jam te oborri im, kurkujt keq s'i kam bërë, edhe m'u hiqni qafe....

**E kujtoni në ç'vit ka ndodhur kjo ngjarje me ju?**

Kam pasur një fëmijë...,një fëmijë, përzotin harroj, kam pas një vajzë të vogël n'atë kohë n'djep, (Veronika, 6-7 mujshe) duke u sjellur, duke u përpjekur, ku: a di unë, kisha atë fëmijë të vogël dhe e gjej përnmys, s'kishte kush me e kthy drejt djepin..., ajo vdiq....(qan me lot për disa minuta, për atë ngjarja që ka ndodhur në vitin 1969. Shënim ynë, D.K.)

**Si reaganu ata pas kësaj?**

Erdhën dhe më vunë prangat, më çuan në Degë të Krutjes, 6 muaj kam ndenjtur në birucat e Krutjes.

**A jua përmendim Bardhokun gjatë periudhës së hetuesisë?**

Joooo, po e kishin për ulje, jooo, një grua e pashkollë, me një kasolle, më ndaluan dhe fëmijët dhe s'mundën dot me shkue te shkolla se u shkatërruan....!

(vijon nesër)

## DIPLOMACIA ANALIZA

# Kur edhe Ivica Daçiç tenton të japë leksione qytetarie?!

Nga Spartak  
TOPOLLAJ



Pak ditë më parë, zv/kryeministri i Parë e njëkohësisht ministër i Jashtëm i Kosovës, Behgjet Pacolli, brenda të gjithë rregullave diplomatike, kërkoi leje nga autoritetet serbe për të marrë pjesë në një aktivitet publik në Novi Pazar, ku edhe ishte i ftuar. Leja iu refuzua për turpin, tashmë të ngrënë me bukë, të autoriteteve shtetërore policore kufitare të Serbisë. Që këtu, duke njohur politiken dhe qëndrimin idiotë të politikanëve serbë, nuk ka pse të habitemi. Por habitim më të madhe, na e shkaktoi një deklaratë edhe më idiotë e zv/kryeministrit të parë e ministër i Jashtëm serb, Ivica Daçiç. Ky farë politikani e kryediplomati i Serbisë, refuzimin e lejes për Pacollin, e motivoi me absurdin, se nëse do e lejonin të ndodhte kjo, do të duhej të sillleshin me Pacollin, as më shumë e as më pak, por vetëm ashtu si u sollën autoritetet e Kosovës, me Marko Gjuriçin. Dhe e gjitha kjo, nuk paska ndodhur, ngaqë serbët, ndryshe prej shqiptarëve, na qenkan të "qytetëruar"!?

Këtu e vërteta dhe historia është se a thjeshtë, aq edhe e qartë për këdo, por megjithatë, e ndjej për detyrë të ndriçoj me fakte e argumente, se ku ndryshojnë dy rastet diametralisht të kundërta. Prej gati 20 vitesh, serbët e kanë humbur njehëri dhe përgjithmonë Kosovën. Ata u shporrën nga Kosova, falë Luftës Çlirimtare të shqiptarëve dhe ndërhyrjes ushtarake e bombardimeve të NATO-s, të udhëhequr nga SHBA. Prej 10 vitesh Kosova e Pavarur është njohur nga 115 shtete të Botës, por jo nga Serbia. Madje në marrin kolektive të tyre, ata vazhdojnë ta konsiderojnë Kosovën pjesë e shtetit serb! Duke mos rështur se provokuari, sidomos me të ashtuquajturin Bashkësi të Komunave Serbe dhe përkujtimet e "festimet" e humbjeve, apo ceremonitë fetare ortodokse (ku Irinej, Artemije dhe Amfilohije, pothuaj nuk mungojnë kur-

rë)! Në larinë provokative të paranojës serbe, një vend të veçantë zënë përpjekjet për të hyrë me forcë, nën pretekste, shpesh herë qesharake, brenda territorit shtetëror të Republikës së Kosovës, të politikanëve apo klerikëve ortodoksë serbë. Autoritetet kosovare, në shumicën e rasteve, me një tolerancë civile të admirueshme, kanë treguar një vetëpërmbytje shembullore, paqka se prepotenca dhe arroganca e eskortave të liderëve serbë tejkalon shumë herë detyrat e tyre. Në plot raste autoriteteve serbe, u është akorduar leja e kërkuar, por të gjithë ata, nuk kanë lënë rast pa humbur, për të shkelur haptazi lejen dhe qëllimin për të cilin edhe e kanë marrë atë. Kulmi kanë qenë dy raste, të cilat, SHBA dhe BE, iu kanë dhënë të drejtë autoriteteve kosovare. I pari që Treni Blu (si dikur ai i blinduari i Titos), të cilin serbët donin ta fusnin forcërisht në Kosovë, pasi s'kishin lënë vend pa shkruar mbi të në shumë prej gjuhëve kryesore "KOSOVA ËSHTË SERBI"! Kup-tohet, që dëshuan me sukses të plotë. Rasti i dytë, ishte kur "trimi" Marko Gjuriç, i paralajmëruar disa herë se po shkelte statusin e tij, qëllimin e lejes së dhënë, e për më keq akoma, në të gjitha rastet propagandante në çdo tubim e aktivitet para përfaqësuesve të pakicës serbe, se Kosova është Serbi?! E pikërisht për këtë, forcat e policisë së Kosovës, u detyruan ta ndalojnë forcërisht, duke e kthyer andej, nga edhe kishte ardhur!

Tani, përpara se të paraqesim shembujt e pafund të sjelljes "qytetare" serbe, që na tregon Ivica Daçiç, ky lektor i vonuar i "qytetarisë e demokracisë" milosheviçiane, le t'i hedhim një sy jetës së këtij dashnori kameleonian të civilizimit. Ivica Daçiç, për ironi të fatit, lindi në Prizren, më 1 janar 1966. Babai, ishte një oficer policie i kohës rankoviciane, kur UDB-ja ishte në apogjeun e terrorit fizik e psikik ndaj shqiptarëve. E ëma, Jelisaveta (Jela) ishte një shtëpiake. Ai kish edhe një motër, Emica. Transferimi i familjes në Zhitovradë koïncidoi me fillimin e shkollimit të tij. Inteligjent si fëmijë, spikati veçanërisht për memorie, aq sa në një gazetë e quajtin "enciklope-




dia me pantallona të shkurtra". Në fëmijëri i vunë nofkën "Bucko". Këtu mbaroi dhe 8-vjeçaren, ndërsa shkollën e mesme e bëri në Nish. Të lartën e kreu në Universitetin e Beogradit për shkencë politike dhe gazetari. Ishte aktivist i njohur i Rinisë Komuniste jugosllave dhe në 1990, u bë i pari president i Rinisë Socialiste për kryeqytetin. Ai është i martuar me Sanjën dhe kanë dy fëmijë, djalin Luka dhe vajzën Andrea. Karrierist provincial, arrivist pragmatik, burrë i lëngët, që merrete formën e enës ku e hidhnin, servil ndaj shefave, e prepotent me vartësit, ra shejpt në sy të Bosit të Bosëve, Slobodan Millosheviçit, të cilit i duheshin të ngjashmit me Daçiç-in, ndaj dhe e përkrahu të ngjiste shkallët e pushtetit, paqka se ai, ashtu i shkurtër siç është, edhe vetë shpesh çante me bërërlja mes politikanëve serbë, përgjithësisht të gjatë.

Karrierën e vërtetë e nisi teksa e bënë botues të organit jetëshkurtër të Partisë Socialiste të Serbisë, "EPOHA". Më pas e shohim në krye të stafit të informacionit dhe propagandës së PSS në zgjedhjet e 1992 dhe 1993. Millosheviçi dhe Mirjana Marković (bashkëshortja dinake dhe e korruptuar e tij, e strehuar politikisht dhe e garantuar financiarisht nga Putin) e mbanin afër Daçiçin, duke i dhënë edhe zyrë në selinë e PSS, apo funksione në organet e zgjedhura të pushtetit për kryeqytetin. Ata ndiqnin me vëmendje ambicjet për pushtet të këtij provinciali

me pamje konviktore, duke e përdorur gjatë spastrimeve në parti dhe e caktuan në disa prej bordeve më të rëndësishme të propagandës, si atë të TANJUG-ut, madje edhe në krye të Këshillit Drejtues Federal të Radio Televizionit Jugosllav. Në 10 shkurt të 2000 zgjidhet në krye të PSS për Beogradin. Revolucionin "Buldozer" 15 tetorit 2000, që nisi, çoi në arrestimin e Millosheviçi-it më 31 Mars 2001 dhe transferimin e tij në Hagë për ta gjykuar si kriminel lufte. Ashtu si Fushe-ja dhe Talejran-i, edhe Daçiç nuk i tradhtonte miqtë, ai vetëm i braktiste ata, kur nuk i duheshin më! (për koïncidencë prej vitesh, ai i ka mbajtur të dy funksionet, ministër i Brendshëm si Fushe dhe i Jashtëm si Talejran)! Në zgjedhjet presidenciale të 2004-ës, shfaqet si kurrë më parë kameleoni i dhe etja e papërmbytur për pushtet e tij, teksa kandidon, duke dëshatur me sukses të plotë, pasi me vetëm 4.04% të votave (125.952), zuri vendin e pestë. Por Daçiç nuk nalet. Në Kongresin e VII të PSS, mbajtur në 4 Dhjetor të 2006-ës zgjidhet Kryetar i saj, duke mundur në raundin e dytë Milorad Vuçeliçin me 1287 vota, kundrejt 792 votave që mori i dyti. Në 2007 zgjidhet në krye të Komitetit të Sigurisë së Parlamentit, ndërsa në 7 Korrik 2008, zgjidhet zv/kryeministër i parë dhe ministër i Brendshëm. Në gusht të 2010, Daçiç e familja e tij, vihen nën mbrojtjen e policisë, pas dyshimeve të Shërbimit Sekret, të konfirmuara

dy vite më pas, se mafia serbe, saktësisht superbosi i drogës Darko Šarić, ofronet 10 milionë euro për vrasjen e Tadiçit dhe Daçiçit, si krerë të koalicionit qeveritar. Këtu është vendi të kujtojmë se mafia serbe e përbërë kryesisht nga ish-oficerë të forcave speciale dhe policisë sekrete të Millosheviçit, e lidhur me politikanët dhe oligarkë, njohur ndryshe si "Klani i Zemunit", vranë më 12 mars të 2003 në Beograd, kryeministrin Zoran Xhinhçiç, mafie kjo që vetëm pak ditë më parë vrau edhe një prej avokatëve të Millosheviçit, Dragoslav Ognjenović. Në zgjedhjet e 2012, PSS mori 14.53% të votave, duke u detyruar të bëjnë koalicion me Partinë Progresiste Serbe (PPS) të Tomislav Nikoliçit dhe me parti të tjera. Nikoliç merr Presidencën, Daçiç qeverinë dhe Jorgovanka Tabakovia, parlamentin. Në zgjedhjet e 2014, fituar nga Partia Progresiste e Aleksandar Vuçicit, në aleancë me të, Daçiç ndërron pozicionin, duke i lënë titullin postin e Kryeministrit dhe vetë mban atë post që ka edhe aktualisht, atë të zv/kryeministrit të parë e ministrit të Jashtëm. Në zgjedhjet presidenciale të Prillit 2017, Vuçic kandidon dhe fiton me 55% të votave, duke i lënë postin e Kryeministrit, Ana Brnabiçit. Nikoliçi, ky varmihës, pasardhës i kriminelit Sheshelj, kontribuoi për ta futur sa më thellë në varr edhe vetë ish- Jugosllavinë. Në 17 shkurt të 2008, siç dihet, Kosova u shpall e pavarur edhe de jure, se de facto kishte gati 10 vite e tillë. Daçiç, në qëndrimin ndaj Pavarësisë së Kosovës, pak a shumë, i ka qëndruar linjës intransigjente të politikanëve serbë të të gjithë krahëve, për të mos e pranuar njohjen Kosovës si një shtet independent, paqka se Gjykata Ndërkombëtare e Hagës, e njohu si të ligjshëm Aktin e Pavarësisë dhe rëzoi Padinë serbe për paligshmëri, duke nxjerrë zbuluar, si jo në pak raste, Serbinë, që vajti të vinte vetulla dhe nxori sytë (kujtoni këtu edhe vendimin përfundimtar të KAS që dënoi Serbinë pas ndeshjes së futbollit në Beograd me Përfaqësuesen e Shqipërisë)! Sot Kosova njihet si shtet i pavarur nga 115 vende të botës. Daçiç në 2011 akuzonte qeverinë e Kosovës



për incidentet në Veri të saj, madje i quante provokime për të penguar Serbinë të aplikonte për praninë në BE! Megjithatë, atij i duhet njohur "merita", që pranoi i pari nga serbët propozimin e SHBA e Brukselit, për të takuar Thaçin, e për të biseduar mbi normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve. Kjo ndodhi në muajt e parë të 2013 dhe vazhdon edhe sot, por pa arritjen e ndonjë rezultati të dukshëm, e kjo për faj të serbëve, të cilët, të iltuar nga Europa për 100 vite, i rrinhin shqiptarët e nuk i llin të qanin, ndërsa sot qajnë, pa i rrahur askush!!!

Le të kthehemi tani, te qëllimi kryesor i këtij shkrimi, pra te leksionet serbe për qytetari, kinse diametralisht e kundërt kjo, me sjelljen e autoriteteve të Kosovës në rastin Marko Gjuriç! Këtu është me vend të kujtojmë se "Buckoja" Daçiç, veç kësaj nofke të fëmijërisë së tij, ka mbajtur edhe nofkën tjetër, më se simjifikative, "Silboja i vogël". Në rolin jashtëzakonisht të vështirë të mbrojtjes dhe justifikimit të krimeve të luftës dhe genocidit serb, nga makina ushtarake-policore e kasapit të Ballkanit, Slobodan Millosheviçit, si përdorues të këtyre, ai "shkëlqeu" vetëm si demagog, gënjeshtar dhe mashtrues! Ky farë enciklopediku me pantallona të shkurtra, që kish fituar edhe konkursin panjugosllav "Tito, Revolucionin dhe Paqja" me 600 adleshentëve të tjerë, kur filloi të merrej me politikë të madhe, u "sëmur" nga amnezia historike, siç rëndom ka ndodhur me politikanët, diplomatët, akademikët dhe historianët shovën serbë! Më preshtje, po përpigimi t'ia freskojmë kujtesën, "Buckos" Ivica, për të vërtetuar se sa me "qytetari" janë sjellë serbët, për shekuj, dekada e vite të tëra, veçanërisht kjo ndaj shqiptarëve.

Sllavët, me tyre serbët, në Ballkan u shfaqën të ardhur nga stepat e thata apo tundrat moçilore rreth shekujve 17-18, kur prej shekujsh në këto treva jetonin pellazgët, e pas tyre, ilirët, helenët, thrakët, dakët, maqedonët (ata të Filipit, Aleksandrit të Madh etj).



Qytetërimi i lartë i tyre, ësh-të tashmë i vërtetuar dhe i argumentuar katërcipërisht nga shkencat e antropologjisë, arkeologjisë, historisë, gjuhësisë, etnografisë etj. Shkodra, Dur-rësi, Berati, Apolonia, Butrinti, Bylisi, etj në trojet tona ishin qytete të zhvillu-ara me urbanizëm, vepra arti e monumente madhështore. I kënduari Daçic enciklope-diku, duhet të ketë lexuar për Lekën e Madh, Pirron, Teutën, Gentin, Bardhylin, Agronin etj, që jo rrallë fitu-an mbi helenët apo romakët, kur për serbët, askush nuk dinte gjë! Ekspansioni sllav në Ballkan erdhi me zjarr, me hekur, apo edhe me ortodok-si të dhunshme, duke shndër-ruar tempujt paganë dhe ob-jektet e kultit kristian katolik, në kisha e manastire ortodokse serbe. Kjo veçanërisht e theksuar në trojet iliro-arbërore. Daçici e di mirë se përballë rrezikut të madh të pushtuesve të rinj otoman, prijësit arbëresho-shqiptar, u bashkuan koaliti-cionit ballkanas, në një nga betejat më të mëdha të shek-ullit XIV-të, asaj të Fushë Kosovës në qershorin e 1389-ës dhe se vrasësi i Sulltan Muratit të I-rë ishte një sh-qiptar, Milosh Nikolla Ko-pililiq (1350-1389), nga fshati Kopilic i Drenicës së Epërme, emrin ortodoks të të cilit, të parët e tij, po kaq mjeshtra sa këta të sotëm, duan ta paraqesin si sllav. Po pse sllavë ishin krerët shqiptarë që morën pjesë në Betejë, si Gjergj Balsha II, Dhimitër Jonima, Teodor Muzaka, Gjon Kastrioti, Andrea Gro-pa etj?! Le të gjejmë serbët një hero kombëtar, të përmasave europiane si ai i Gjergj Kas-triotit?! Klerikët serbë ortodoksë përdorën thikën dhe helmën në shekuj, duke ndryshuar forcërisht to-ponimet iliro-arbërore, po ashtu si dhe pushtuesit o-tomanë pas tyre.

Në shekullin XIX, serbët ringjallin mitin e Betejës së Fushë Kosovës, lënë në har-rësë mbi tre shekuj. Ata, të mbështetur te topomimia dhe antropomimia e ndryshuar dhunshëm prej tyre apo os-manëve donin t'i paraqitnin shqiptarët si të ardhur me Turqit, por tre mendje të shquara të kohës, veç të

tjerash, i hedhin poshtë përfundimet e vonuara "shken-core" serbe. Ami Bue, (frëng), Spenser, (britanik) dhe Hahn, (austriak), në gjysmën e parë të shek. XIX-të, vizituan dhe treguan ku janë trojet shqiptare. Teksa Turqia dobësohej dhe serbët fituan autonominë e më pas pavarësinë, gjithnjë me mbështetjen e mëmës Rusi, shfaqën haptazi pretendimet mbi trojet shqiptare. Kongresi i Berlinit, 1878 e si-domos Konferenca e Ambasadorëve në Londër, (Dhjetor 1913), përgjysmuan terri-torin shqiptar, në favor të fqinj-ëve. Lidhja Shqiptare e Prizrenit, qershor 1878 që shpalli Autonominë, u "har-rua" nga Europa e kohës. Gjatë gati 35 viteve serbët, sidomos në Veri të trevave shqiptare, kryen krime të përbindshme, të cilat, Daçic mund t'i gjejë lehtësisht në veprat e shumë autorëve ser-bë, ku shquajnë dy prej tyre, historianë që guxuan të thonë e të shkruajnë të vërtetat e tmerrshme mbi krimet e përbindshme të shovenëve serbë, Dimitrije Tuçovic dhe Dubravka Sto-janovic, e meqenëse mbahet edhe si anglistfolës, le të lexojë Aubrey Herbert, dip-lomatitn e shquar britanik, në "The Times" të Londrës e gazeta të tjera në Shtator-Tor të 1913-ës! Le të pyesë Daçic, si dhe kush i vrau legjendat e kryengritjeve të mëdha antiturke e antiser-be Ded Gjo Luli, Mehmet (Sokol) Shpendi dhe Is Boletini?! A e di Daçic se kush i dogji tre herë kullat e Ndreve të Dibrës më 1913, 1918 dhe 1921?! A ka dëgjuar gjë për kryengritjet e mëdha antiserbe të Dibrës dhe legjendën që i udhëhoqi ato, Elez Isuf Ndreu? Barbaritë e serbëve që vranë, prenë, dogjën, shkatërruan çdo gjë, përdhuanin gra e vajza, u ngulën bajonetat grave sh-tatzëna, ishin aktet e "qytetarisë" serbe, për të cilat na jep leksione sot Iv-ica i Sllobos! Edhe mes dy luftërave Botërore, nuk rrashtin krimet dhe deportimet e dhunshme të sh-qiptarëve nga serbët e "qytetaruar".

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, shqiptarët në Jugosllavi, e patën vështirë

të binden për të ashtuquaj-turin Villazërim-Bashkim, (Bratsvo-Jedinstvo) mes popujve, që predikimin komu-nistë e Titos, pas të cilit sh-konte edhe Enver Hoxha, ser-vili më i pëshitur i tij, deri në neveri dhe i të deleguarve të PKJ, Popoviazë e Mugoşa, Jo-vanovicë e Tempo, Stojnicë e Dizdarevic etj etj. Autoritetet italiane dhe gjermane të pushtimit, duke njohur urretjen e akumuluar të shqiptarëve ndaj sundimit të gjatë e të egër serb e shfrytëzuan në interes të tyre këtë, nisur dhe nga fakti që ata shpallën bashkimin e trojeve sh-

qiptare dhe vendosën admin-istratën vendase po me sh-qiptarë, e hapën kudo shkollat shqipe. Komunistët jugosllavë, s'mund ta pranoin kurrë këtë, ndaj dhe na-cionalizmin për një Shqipëri etnike dhe refuzimin për t'u vëllazëruar me komunistët e inkuadruar në njësitë luftar-ake të Armatës së Titos, nuk ia harruan lehtë dhe s'ua falën kurrë shqiptarëve. Dhe më kriminal e më tragjik ësh-të masakra e Tivarit, e 1 Pril-lit 1945, kur u masakruan pa-besisht mijëra shqiptarë të mobilizuar me forcë nga Ar-mata Jugosllave, në prani të njëjsteve partizane të UÇNSH, që i shoqëronin. Kryekriminelit stalinist En-ver Hoxha, priti gati 40 vjet-ta denonconte këtë masakër të tmerrshme, në pamfletin "TITISTËT", paçka se kishte rreth 35 vite që ishte "prishur" me Titon. Kjo

masakër, e ngjashme me atë të Katinit në Poloni me ur-dhër të Stalinit, ishte pranuar në dokumente zyrtare të udhëheqjes titiste, e më pas gjatë raportimit para Kong-resit të PKJ në Maj të 1945 nga vetë famëkeqi Ranko-viazë, i cili, ndryshe nga c'shkrubehj në dokumentin zyrtar, ku pranohej elimini-mi i 420 djemve të rinj koso-varë, e uli në rreth 300 num-rin e tyre, duke zvogëluar me disa fish numrin e tyre!!!

Krimet serbe nuk resh-tën edhe gjatë 35 viteve të sundimit të Mareshal J.B.Titos. Nën pretextin e mbledhjes së armëve, u eliminuan, u torturuan mi-zorisht, u burgosën e u inter-nuan mijëra shqiptarë. Pas shkarkimit të Rankoviçit serb (1966), fajet u veshën atij, por i sofistikuari antish-qiptar Tito, nuk e ndali repres-ionin. Kështu, me gjak e dhunë e shtypën demon-stratat e 1968 për flamur, au-tonomi e universitet, që detyruan Titon, nga frika e ndonjë revolte më të madhe mbarëshqiptare, më në fund t'i pranonte. Fill pas vdekjes së tij (4 Maj 1980), shpërthy-en në Kosovë, demonstratrat e Pranverës '81, me kërkesë kryesore, "KOSOVA REPUB-LIKË", ku mbetën dhjetëra të vrarë, pas të cilave filloi procesi poshtërues i "DIFER-ENCIMIT", një lloj apartejdi racist antishqiptar, i cili goditi egërsisht intelektualët, akademikët, profesorët uni-versitarë, arsimitarët,

politike demokratike në gjithë Lindjen Komuniste. Kjo, pas suprimimit nga Mi-losheviç në mars, të Kush-tetutës së 1974-ës, që i njihte autonominë e shumë liri e të drejta shqiptarëve. Edhe pse LDK e lideri historik isaj dhe i Kosovës, Dr. Rugova u shprehën në mënyrë ekspl-icite për Kosovën Republikë, ata ishin për rrugën paqë-sore të mbërritjes së qëllimit final, në 2 Korrik 1990 Kuv-endi i Kosovës shpalli Repub-likën e Pavarur dhe miratoi Kushtetutën e Re, ndërkohe që më 7 Shtator 1991 Referen-dum me mazhorancë abso-lute e njohu Pavarësinë. Në 1992 zhvillohen zgjedhjet presidenciale e parlamen-tare dhe Rugova zgjidhet President. Serbia "qytetare", gjithnjë sipas Daçic-it, i treg-on dhëmbët, siç kish bërë edhe me gravat e minatorëve të Treçpës e Stari-Tërgut,

nizmit, të mbrohej e justifikoh-ej diktatori më i egër i Ball-kanit, që shkatërroi me luftë Jugosllavinë, vrau dhjetëra-mijëra njerëz në Vukovar, Srebrenicë, Recak etj, duke kryer gjenocid, krime lufte, përdhunime e deportime të tmerrshme në Bosnjë, Kroa-ci e Kosovë. Por ai, me gjithë përpjekjet dhe artin e tij të demagogjisë, nuk e shpëtoi dot sheq Sllobon, i cili nga Pallati i Bardhë i mbretërve në Beograd, i arrestuar, u transferua ne Holandë, shumë afër Pallatit Mbretëror në Hagë, në bur-gun e Sheveningenit të Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës! Sllobo u gjykua për krimet e tmerrshme që bëh-në serbët, nën udhëheqjen e tij, të Karaxhiçit, Mlladiçit, Shesheljit, Arkanit e të tjerëve, por vendimin përfun-dimtar me vdekje, Sllobodan-it, ia dha i "Plotfuqishmi". Arkanin e Cecas e vranë në mes të Beogradit, ish miqtë e dikurshëm të supermafias serbe, ndërsa tre të tjerët e sipërpërmendur, (si dhe shumë të tjerë kriminelë ser-bë), u dënuan me afatë të gja-ta burgimi.

Në Kosovë, të shtunën e 23 dhjetorit 1989, një grup intelektualësh, akademikë, profesorë universitarë, sh-krimtarë, gazetarë dhe stu-dentë me Ibrahim Rugovën në krye, të frymëzuar edhe nga legjenda e burgeuve Adem Demaçi, themeluan Lidhjen Demokratike të Ko-sovës, e cila që e para parti

mbyll shkollat e Universite-tin dhe komandon në krye të çdo institucioni drejtues ser-bë! Shqiptarët dhe Qeveria e Dr. Bujar Bukosh-it, hapin shkollat paralele që mbahen me 3% e të ardhurave të çdo emigranti. Milloseviçi nuk priti më gjatë, por dërgoi ush-trinë, policinë, tanket dhe blindat. Kjo që rruga "demokratike e Qytetare" e Sllobos të cilës shqiptarët paqësorë iu përgjigjën me krijimin e FARK-ut, ndaj të cilit qeveria shqiptare dhe presidenti Berisha dhanë mbështetje të fuqishme, më pas edhe UÇK, ku shquante komandanti legjendar Adem Jashari, njësitë luftarake të së cilës, po rriteshin e forco-heshin nga dita në ditë, deri sa në fund të Luftës mbër-riten deri në 20.000 luftëtarë. Lufta u zhvillua gjatë 15 muajve: 28 Shkurt 1998-11 qershor 1999, ku vendimtare ishte ndërhyrja ushtarake e NATO-s, sidomos bom-bardimet e saj deri edhe mbi Beograd. Serbëve nuk u bëri punë as ndihma e gjithan-shëm ruse në logjistikë e ar-matime, e sidomos me mer-cenarë kriminelë të degrad-uar si pijanecë e drogmënë. Mes shumë betejave, beteja dhe fitorja më e madhe gjatë Luftës, ishte ajo e Kosharës.

Tetë masakrat më të mëdha të serbëve në Kosovë ishin: e Prekaz-it (56 Jasharaj-t), Reçakut, (45 të masakru-ar; denoncuar botërisht nga ambasadori amerikan i OSBE William Walker), Izbicës, Rezallës, Dubravës, Krushes së Madhe (Ra-hovec), Rugovës së Hasit dhe ajo e Studimes (Vushtrri)

Pasojat e krimeve serbe: 11 843 të vrarë (1.392 fëmijë dhe 1.739 femra). Dëshmorët 2.261, 68 nga Shqipëria, ende të pag-tyr 1.450 shqiptarë, u dhunuan 20.400 femra. U sh-katërruan 188.000 ndërtesa (shtëpi, shkolla, biblioteka, qendra shëndetësore, xhami, kisha katolike) dhe u depor-tuan me dhunë 782.100 njerëz.

Daçic "po bën petulla" për një ndarje të Kosovës, dhe me shefin e ri, Vuçic (një tjetër kameleon politik serb ky, i rilindur, pasi ishte ndër më konfidentët e kriminelit Sheshelj) zgjasin pa fund bisedimet e Brukselit?! Ana Brnabiçin e kanë lënë të mer-ret me hallet e mëdha që kanë shoqatë e LGBTI (si e dyta Kryeministre e Serbisë, pas Petar Zivkoviçit (1879-1947) e deklaruar GAY. Nuk dihet çfarë duhet t'i ketë thënë Ues Micell atij (se Sekretari Pom-peo s'pati kohë ta priste), apo nëse ia mori këngës në Uash-ington këto ditë, si para "Sul-tan" Erdoanit, vëllait mys-li-man të kryeministrit tonë ortodokso-katolik, por një gjë dihet mirë: Kosovën nuk ka forcë që ta ndajë! Presidenti Trump, e di mirë si vihen në rresht Kimët e Koresë, Ru-hanët e Iranit, apo këta Vuçiqët e Daçiqët dhe gjithë HIÇET e tjerë të Serbisë. Këtë shkrim po e mbyll me një py-etje: a mund të na japë përsëri leksione demokracie e qyteta-ria nga serbët Ivica Daçic?!

**(Historian dhe diplomati i karrierës, Departamenti i Marrëdhënieve Ndërko-mbëtare i Partisë Demokratike)**



Nga Albert Einstein te SERGEY BRIN, ja figurat më të njohura që frymëzuan me veprat e tyre


# Të famshëm në tokë të huaj, emigrantët që ndryshuan botën

*Shkencëtarë, humanë, shpirtërorë - yjet që iluminuan tokën ndër vite*

**E** është e çuditshme se si njerëzit arrijnë të bëjnë mrekullira në vende të tjera, duke arritur kështu që me veprat e tyre të ndriçojnë sadopak botën. Qoftë duke i ikur persekutimit, qoftë duke kërkuar mundësi të reja, këto figura u zhvendosën në toka të reja dhe gjtën suksesin.

**ALBERT EINSTEIN (GJERMAN/AMERIKAN 1879-1955)** Albert Einstein mbajti tre nënshtetësi gjatë gjithë jetës së tij. Ai lindi në një familje laike hebreje në Gjermani dhe ndoqi shkollën në Mynih, por në moshën 17 vjeç hoqi dorë nga nënshtetësia gjermane për të shmangur shërbimin ushtarak. Në vitet që pasuan studioi në Zvicër dhe u bë nënshtetas zviceran. Atje zhvilloi teorinë e tij të relativitetit të përgjithshëm dhe fitoi Çmimin Nobel për fizikën, përpara se të bëhej profesor në Berlin. Kur nazistët morën pushtetin, ai u largua për në SHBA për t'i shpëtuar persekutimit, dhe në vitin 1940 u bë nënshtetas amerikan. Një nga thëniet e famshme: "Nëse teoria ime rezulton e pavërtetë, Franca do të thotë se jam gjerman dhe Gjermania do të thotë se jam hebre".

**MADELEINE ALBRIGHT (ÇEKE/AMERIKANE 1937 - )** E para Sekretare Shteti femër e SHBA, ajo u lind me emrin Marie Jana Korbel në Çekosllovakia, por kur ishte ende fëmijë, ajo dhe familja u larguan nga vendi pas pushtimit prej nazistëve. Kërkuan strehim në Angli gjatë Luftës së Dytë, por pasi u kthyen prej shumë pak kohë në Çekosllovakia u larguan sërish, kur në pushtet erdhën komunistët. Këtë herë udhëtuan për në SHBA, ku Korbel studioi politikë dhe krijoi një familje me Joseph Albright. Pasi punoi për Këshillin Kombëtar të Sigurisë, ajo u emërua ambasadore në OKB nga presidenti Clinton, i cili më pas e emëroi Sekretare Shteti, duke e bërë gruan me postin më të lartë në qeverinë amerikane.



Albert Einstein

**HANS HOLBEIN (GJERMAN/ANGLEZ 1497-1543)** Pasi studioi nën mbikëqyrjen e të atit, artistit Hans Holbein i madh në Augsburg, Gjermani, Hans Holbein i ri u zhvendos në Bazel të Zvicrës. Piktori udhëtoi nëpër Evropë duke prodhuar afreske dhe punime druri, por përhapja e reformimit bëri që kërkesa për veprën e tij të ishte në rënie. Në vitin 1526, ai udhëtoi në Angli të kërkonte punë, dhe siguroi një të tillë si artist personal i Mbretit Henry VIII, duke prodhuar kështu disa prej pikturave më të famshme të shekullit 16. **WILLIAM I (NORMAN/ANGLEZ 1028-1087)** William Pushtuesi, i pari mbret norman i Anglisë, e mori me forcë atdheun e ri, por nuk kish pse të ishte kështu. Duka i pamëshirshëm i Normandisë pretendoi se ishte premtuar kurora e Anglisë nga kushëriri i tij i largët, Edëard Pushtuesi, i cili ishte

mbreti pa fëmijë i Anglisë në atë kohë. Megjithatë, kur Edward vdiq, Harold Godwinson u shpall trashëgimtar i tij. William u trëbua që Harold, një njeri që ishte betuar ta ndihmonte të merrte fronin, e kish tradhtuar; dhe kështu udhëtoi në Angli për t'u përballur me të. Harold u vra në betejë dhe William u bë më në fund mbret i Anglisë. **NËNË TEREZA (SHQIPTARE/INDIANE 1910-1997)** "Me gjak, jam shqiptare. Me nënshtetësi indiane. Me besim jam katolike. Sa për thirrjen time, i përkas botës". Këto ishin fjalë të vetë Nënë Terezës, tek përmbledhte një jetë si bamirëse. E lindur nga prindër shqiptarë, ajo i kaloi 18 vitet e para të jetës në Shkup, nën perandorinë osmane. Pasi u bashkua Motrave të Loretos në Irlandë, ajo udhëtoi për në Indi për t'u bërë mjesuese, dhe pikërisht aty përjetoi thirrjen e parë për t'u kushtuar ndih-

mës për të varfrit në Kalkutë. **CAROLINE HERSCHEL (GJERMANE/ANGLEZE 1750-1848)** Caroline dhe vëllai i saj, Ëilliam Herschel fillinin, ai u emërua astronom i oborrit për mbretin George III. Më pas, Caroline nisi ta ndihmojë me llogaritë e tij, dhe shumë shpejt zhvilloi një interes në qiellin e natës. Përmes vëzhgimeve të veta, ajo zbuloi shumë yje dhe kometa më parë të pazbuluara, shumë prej të cilëve morën emrin e saj, si dhe mori medaljen e artë të Shoqërisë Astronomike Mbretërore. **JOSEPH PULITZER (HUNGAREZ/AMERIKAN 1847-1911)** I vendosur të bëhej ushtar; 17-vjeçari Joseph Pulitzer u përpoq të hyjë në ushtrinë austriake dhe britanike, por u refuzua për shkak të shikimit të dobët. Më pas u rreshtua në Ushtrinë e Unionit në SHBA si zëvendës dhe shkoi në Amerikë. Atje nisi karrierën e tij si gazetar dhe botues i suksesshëm, duke e transformuar industrinë e gazetave. I la një pasuri Universitetit të Columbias, që më pas krijoi Çmimin Pulitzer për arritje artistike dhe gazetareske në nder të tij. **SONIA GANDHI (ITALIANE/INDIANE 1946-)** Pasi u martua me studentin Rajiv Gandhi teksa studioje në Angli, Sonia Gandhi bëri një jetë të qetë në Indi, me bashkëshortin e saj pilot avioni dhe dy fëmijët. Megjithatë, kur u bë kryeministre në 1984, ajo doli në skenë. Rajiv u vra tragjikisht në 1991 dhe Sonia u ftua të marrë vendin e tij si Presidentente e Kongresit Kombëtar

Indian. Fillimisht refuzoi, por kur në parti nisi lufta, ajo më në fund e pranoi rolin. Thënia e saj e famshme: "Unë jam indiane. Në fakt, ndihem e huaj kur shkoj jashtë". **LEVI STRAUSS (BAVAREZ/AMERIKAN 1829-1902)** Pasi përjetoj persekutimin hebre në Bavari, Strauss dhe familja e tij u zhvendosën në SHBA, ku Levi krijoi biznesin e tij të shitjeve me shumicë. Në vitin 1872, një prej klientëve të tij, një rrobaqepës letonez me emrin Jacob Davis, i dha një ide për një mënyrë të re të të bërit të pantallonave, që i bënte ato më të forta dhe të qëndrueshme, shkruan Bota.a. Levi ra dakord të bëhej partneri i biznesit dhe më pas të dy morën patentën për blu xhinset. **SERGEY BRIN (RUS/AMERIKAN 1973 - )** Sot imigranti më i pasur në SHBA, Sergey Brin u largua nga Bashkimi Sovjetik bashkë me familjen kur ishte vetëm 6 vjeç, që t'i shpëtonte persekutimit ndaj hebrenjve. Më pas ndoqi gjurmët e të atit duke studiuar matematikë, përpara se të shkonte në Stanford për një PhD në shkencë kompjuterike. Atje u takua me Larry Page, dhe si një projekt kërkimor; të dy nisën të krijojnë një motor kërkimi që i rendiste faqet sipas popullaritetit - e gjithë kjo, nga konvikt i tyre. Në fillim i quajtën BackRub, por shumë shpejt ia ndryshuan emrin në Google, të frymëzuar nga termi matematikor "googol", dhe e regjistruan në vitin 1997. Pas vetëm shtatë vitesh ishin të dy miliarderë.



**SHBA, ndërron jetë senatori republikan John McCain**

**K**a ndërruar jetë në moshën 81-vjeçare, senatori republikan John McCain. McCain ka ndërruar jetë të shtetë, në shtetëpinë e tij në Arizona, njofton zyra e tij e shtypit. McCain ishte senator për tre dekada dhe ishte diagnostifikuar me kancer në tru që në korrik të vitit 2017. Senatori republikan ishte operuar gjatë prillit të këtij viti. McCain i ka shërbyer Shteteve të Bashkuara të Amerikës për disa dekada dhe kishte garuar edhe në zgjedhjet presidenciale. Sipas njoftimit nga familja e tij, McCain ndërroi jetë pasditën e së shtunës, pranë gruas së tij, Cindyt.

## Kanali i Otrantos, rruga e "artë", për trafikantët e kanabisit

**K**anali i Otrantos vijon të mbetet rruga kryesore e trafikantëve të kanabisit. Nga janari i këtij viti deri në Gusht, në rajonin e Puglias janë kapur në operacione të përbashkëta të policisë se vendit fqinj dhe asaj shqiptare 13 tonë hashash në 12 ngarkesa. Mediat italiane shkruajnë se janë arrestuar 31 skafistë, shumica prej tyre shqiptarë dhe një numër i vogël janë shtetas italianë. Ngarkesat variojnë nga 300 kilogramë deri në 1 ton. Pavarësisht se në dy vitet e fundit, sipas statistikave të policisë kultivimi i kanabisit ka qenë thuajse zero, niveli i trafikut drejt Italisë rezultoi i lartë. Droga e trafikuar besohet se është stoku i kanabisit të mbjellë gjatë viteve 2015-2016. Ngarkesa të konsiderueshme janë kapur edhe në Greqi. 3 tonë është sasia e sekuestruar në kufirin mes dy vendeve, transmeton TG. Sipas të dhënave të përditësuara të CIA FactBook, Shqipëria vijon të jetë një ndër vendet më të rëndësishme nga ku furnizohet me lëndë narkotike tregu europian.

## Hashim Thaçi: Kosova do t'i përmbushë kriteret për në BE

### Kancelari Kurtz: Marrëveshja Kosovë-Serbi, parakushti kryesor për anëtarësim

**P**residenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, zhvilloi një takim të përbashkët me kancelarin austriak, Sebastian Kurtz, komisionerin e BE-së për Zgjerim, Johannes Hahn, dhe presidentin e Serbisë, Aleksander Vučić. Kancelari austriak, si mikpritës i këtij takimi, theksoi se Austria gjatë udhëheqjes së presidencës së BE-së, prioritet kryesor do të ketë politikën e zgjerimit dhe të fqinjësisë së mirë, si dhe ato të sigurisë dhe migracionit. Një çështje tjetër, e cila ishte fokus primar i këtij takimi, ishte edhe procesi i dialogut

për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, i ndërmjetësuar nga BE-ja. Lidhur me këtë proces, kancelari Kurtz inkurajoi të dy presidentët për të vazhduar përpjekjet e tyre për të arritur marrëveshje. "Arritja e marrëveshjes është parakushti kryesor për anëtarësimin e dy shteteve në BE. Austria mbështet dialogun dhe arritjen e marrëveshjes, si dhe inter-



grimin e shteteve të Ballkanit Perëndimor në BE", theksoi Kurtz. Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, i shprehu mirënjohje Austrisë për ndihmën në kuadër të procesit të integritimit në BE dhe arritjes së marrëveshjes eventuale paqësore me Serbinë. Kreu i shtetit theksoi se Kosova, me përkushtim, do t'i përmbushë kriteret për anëtarësim në BE dhe do të bëjë përpjekje serioze për

arritjen e marrëveshjes paqësore ligjore me Serbinë. "Përkrahja e Austrisë dhe e shteteve të tjera anëtare të BE-së, përkrahja e vazhdueshme e SHBA-ve për arritjen e marrëveshjes janë vendimtare në këtë fazë përfundimtare të këtij procesi të vështirë, por të domosdoshëm", theksoi presidenti Thaçi. Ndërkohë, gjatë qëndrimit në Austri, presidenti Thaçi ka zhvilluar edhe takime tjera me përfaqësues të shteteve të BE-së, të rajonit, profesorë, shkencëtarë dhe personalitete të ndryshme botërore.



## MJEKU POPULLOR



Si të normalizoni nivelin e kolesterolit me bimë mjekësore

## KESHILLA



Konsumoni çaj me gjethe manaferre për një zemër të fortë

# Arqile Gjikondi:



◆  
Mjeku nefrolog internist: Pse shfaqet impotenca e papritur te moshat e reja aktive

## Shkaqet e dhimbjeve seksuale te meshkujt

"Si të kuroni prostatën e irrituar"

10 këshilla të thjeshta për të luftuar pagjumësinë

Voltiza Duro

Vitet e fundit, impotenca po prek jo pak meshkuj, veçanërisht ata të moshave të reja. Por jo rrallëherë kjo sëmundje shoqërohet edhe me shqetësime të tjera në rrugët urogenitale, e mund të sjellë edhe irritimin e prostatës, e cila quhet ndryshe edhe "truri" i seksit. Në një intervistë për suplementin "Life Pages", mjeku nefrolog internist, Arqile Gjikondi tregon të gjitha simptomat kryesore të prostatës së irrituar dhe më tej shton se meshkujt e prekur mund të vuajnë edhe nga hemorroidet, çrregullimet e tjera të zorrëve (kapsllëk apo diarje) apo edhe çrregullime të urinimit. Gjikondi tregon se kombinimet e përzgjedhura të antibiotikëve dhe medikamentëve të tjera ndihmëse japin rezultate të shkëlqyera, ku rreth 85% e pacientëve shërohen.

**Si paraqiten rastet e rënies së aktivitetit seksual të meshkujt?**

Në praktikën mjekësore gjithmonë e më shumë po ndodhin rënie seksuale të papritura në komunitetin mashkullor, sidomos në moshat e reja. Përgjithësisht sëmundja vjen papritur tek meshkujt që janë shumë aktivë dhe të fuqishëm seksualisht. Simptomat shfaqen krejt papritur brenda disa ditësh e fillon të shfaqet rënia e ereksionit, nuk arrijnë të mbarojnë aktin seksual, nuk arrijnë në orgazëm të plotë, ose e arrijnë atë shumë shpejt (sekonda ose minuta) në kundërshtim me dëshirën e tyre për ta zgatur aktin.

**Cilat janë shkaqet që ndikojnë në zhvillimin e kësaj sëmundjeje?**

Shkaqet janë të shumta, duke filluar nga shkaqe psikologjike, apo konsumimi i alkoolit, drogës, duhanit (të cilat në një moment të caktuar do të çojnë në një impotencë relative seksuale, pra nuk do të jenë aq të fuqishëm sa kanë qenë dikur). Rënia seksuale tek këta persona është pothuajse e pashmangshme.



Mjeku nefrolog internist: Pse shfaqet impotenca e papritur te moshat e reja aktive

# Arqile Gjikondi: Shkaqet e dhimbjeve seksuale te meshkujt

*"Si të kuroni prostatën e irrituar"*

**A shoqërohet impotenca edhe me shqetësime në organet urogenitale?**

Ka edhe një kategori meshkujsh që krahas rënies seksuale kanë edhe simptoma të tjera që lidhen me organet urogenitale, një prej të cilëve është prostata, që mendohet dhe cilësohet si truri i seksit. Irritimi i gjëndrës së Prostatës është një nga shkaqet më të shpeshta për dhimbjet seksuale tek meshkujt aktive.

**Mund të na tregoni disa prej simptomave kryesore që shfaq prostata e irrituar?**

Në qoftë se ju ndjeni dhimbje seksuale, që përmbledhen me dhimbje të penisit, testikujve, ose në fundin e barkut, rrëzë kofshëve, të cilat ndodhin gjatë seksit ose pas seksit, ka shumë mundësi që ju të vuani nga prob-



Mjeku nefrolog internist, Arqile Gjikondi

lemet e irritimit të prostatës, pavarësisht moshës së re që keni. Seksi mendohet që është

një akt i cili duhet të sjellë kënaqësi superiore, kështu është i kuptueshëm stresi dhe paniku që ndiejnë meshkujt që përjetojnë dhimbje gjatë aktit seksual me të gjitha pasojat psikike që vijnë më pas (dëshpërim, ankth, pasiguri etj). Por vlen të theksoj se këta meshkuj mund të kenë edhe çrregullime të ejakulacinit (i shpejtë, i dhimbshëm, me djegie, rënie të sasisë së spermës, trashje e saj që në pamje duket si silikon me kokrra, ngjyrë e verdhë, kafe, ose nuk ejakulojnë dot). Këta persona, gjithashtu, mund të mos ndiejnë kënaqësinë e orgazmës. Shpesh kanë dhimbje në Anus, ndjenjën e defekimit të vazhdueshëm.

**Sa të predispozuar janë këta meshkuj për t'u prekur edhe nga sëmundje të tjera?**

Kategoria e meshkujve të sipërmendur vuajnë nga hemorroidet (majasëll) kronik, ose nga çrregullimet e tjera të zorrëve (kapsllëk apo diarje). Po ashtu mundet që të ndiejnë edhe çrregullime të urinimit, shpeshtësi, urgjencë, djegie, dhimbje, e madje mund t'u duket sikur nuk e zbrazin qesen e urinës plotësisht, kështu që duhet të shkojnë disa herë në tualet.

**Si bëhet diagnostikimi i sëmundjes?**

Të gjitha këto simptoma që përmenda më lart, zakonisht nuk shoqërohen me çrregullime në analiza apo në ekzaminimet me eko, kështu që pacientët sorollat në disa mjekë dhe klinika, pa e ditur se çfarë sëmundje kanë. Sëmundja që përmbledh këto çrregullime quhet prostatit kronik ose dhimbje kronike të legenit.

**Si bëhet trajtimi i prostatës së irrituar?**

Së pari dua të theksoj se nga këto çrregullime vuajnë rreth 20-40% e meshkujve të moshës aktive. Mjekimet e zakonshme përgjithësisht nuk kanë efekte. Ndërkohë që kombinimet e përzgjedhura të antibiotikëve dhe medikamentëve të tjera ndihmëse janë me rezultate të shkëlqyera. Në eksperimentencën time si mjek mund të them se rreth 85% e pacientëve shërohen.



Voltiza Duro


Nëse dy tipat e kolesterolit nuk i ruajmë brenda vlerave atëherë mund të sjellin lindjen e sëmundjeve të ndryshme si hipertensioni aritmia, problemet në veshka apo pagjumësia. Kolesterolit LDL i quajtur kolesterolit i keq është lipoprotein me densitet të ulët. Këto lipoproteina shpeshherë depozitohen në muret e brendshme të arterieve duke ngushtuar diametrin e tyre. Ndërsa kolesterolit HDL i njohur si kolesterolit i mirë është lipoprotein me densitet të lartë. Këto grimca pastrojnë enët e qarkullimit të gjakut nga LDL dhe kur ato rriten shumë mbi vlera e depozitojnë LDL në mëllçi. Kur LDL, HDL dhe VLDL kalojnë mbi vlerat 280 mg/çdo 300mg/dcl 400mg/dhe atëherë shfaqen shqetësimet në zemër. Në rast se personi nuk fillon të tregojë kujdes për të ulur kolesterolin, atëherë fillon procesi i përgjithësuar që gradualisht dhe në mënyrë të vazhdueshme arteriet të fillojnë të mbushen vende-vende nga brenda me këto pllakëza dhjamore. Në përgjithësi ky proces fillon të ndihet pas moshës 40-45 vjeç. Disa prej faktorëve që ndikojnë në rritjen e kolesterolit në gjak janë: jeta e qetë, qëndrimi sedentar, obeziteti, dieta e pashëndetshme, duhanpirja, diabeti.

## SIMPTOMAT

Vërehet një fryrje e gishtave të dorës, shpeshherë personi fillon të ndiejë dhimbje koke, mund të ketë dhimbje në kraharor, ndonjëherë mund të ketë një goditje në zemër ose shtrëngim të saj. Gjithashtu, mund të ndiejë dhimbje të kyçeve të këmbëve, "ndezeje" të tyre. Personi në mëngjes kur çohet nga gjumi fillon të eci duke kaluar dhe shenja të harrësës. Tek disa persona mund të shfaqet ankth, marrje mendsh, lodhje e shpejtë, dhe vështirësi në frymëmarrje. Në rast se LDL fillon të rritet mbi 150-180 mg/dcl-210 mg/dcl, atëherë këto lipoproteina fillojnë tu ngjiten arterieve nga brenda dhe vende-vende fillon sklerotizimi i arterieve e kundërta ndodh me HDL. Kur ky fillon të ulët me poshtë se 35mg/dcl atëherë pakësohet mundësia e pastrimit të LDL. Pra, siç e shohim e kryesore është që të mbajmë HDL me shume se 35mg/dcl dhe trigliceridet fillojnë të rriten mbi 150 mg/dcl.

## PARANDALIMI

Ushtrimet fizike dhe aktiviteti fizik janë ndër të parët që fillojnë të luftojnë arterosklerozën. Një vrap 5-10 minutë nxit shumë qarkullimin e gjakut dhe ndihmon në shkëputjen e këtyre grimcave nga vendi ku janë ngjitur. Konsumimi i ushqimeve me pak krripë dhe pakësimi i ushqimeve të skuqura bën që të mos rritet tensioni dhe mëlcia të



Mjeku: Cilat janë simptomat e para që s'duhen neglizhuar, dy tipat e sëmundjes

# Ylli Merja:

## Si të normalizoni nivelin e kolesterolit me bimë mjekësore

*"Konsumoni vajin e lirit, majdanozin e kanellën"*



Ylli Merja

punojë me shume për depozitimin e LDL. Konsumimi i produkteve shtazore pakëson mundësinë e shtimit të kolesterolit ndërkohë që ne i kemi shpallur luftë të heshtur atij. Përdorimi i mishit të peshkut në veçanti salmonit bën që omega acidet yndyrore të pangopura të ndikojnë në uljen e kolesterolit total. Ushqimet më fibra që përmbajnë Beta Glukan largojnë toksinat nga organizmi dhe largojnë LDL. Konsumimi i ushqimeve që përmbajnë Gluteinë një antioksidant me ngjyrë të verdhë që gjendet tek spinaqi veza aloe vlera, tangel gjaku ndikojnë në humbje të LDL dhe

triglicerideve. Konsumimi i frutave të thata si arra 4-6 kokrra në ditë, bajame 6-8 kokrra në ditë ose edhe lajthi ndikon në rritjen e HDL. Konsumimi i bishtajoreve si fasulet, bizelja thirrja etj, duke qenë se kanë antioksidant, vitaminë D, vitaminë B, magnez, kalimi, hekur dhe lectina një substancë që të bën të ndihesh i ngopur, reduktun LDL dhe rrit kolesterolin e mirë deri në masën 30-35%. Përdorimi i sojës avokados hudhrës qitro bën që të ulin LDL deri në 20% dhe të rritet HDL 25-30%. Konsumimi i 2-3 frutave të stinës në ditë ndikon në largimin e LDL. Përdorimi i uthullës së mollës së egër në

dozën 1-2 lugë gjelle në ditë ul nivelin e triglicerideve dhe rrethimisht ul kolesterolin VLDL.

## KURAT POPULLORE

Krahas ushqimeve të përditshme që përmbajnë antioksidant, vitaminën B, fibra të shumta; një ndihmës shumë i mirë për të ulur kolesterolin brenda një periudhe 1 mujore japim bimët mjekësore. Ja cilat nga bimët ju mund ti përdorni që brenda një muaji kolesterolin ta ulin 50-70mg/dcl. Të gjitha bimët që përmbajnë acide organike ulin kolesterolin në gjak. Lulja dhe fruti i murrizit përmban acidin triterpenik, molla e egër përmban acidin malik në përqindje të lartë, kafja pa kafeinë dhe fruti i shtogut përmbajnë acidin klorogenik që ndikon në shkrirjen e dhjamit

në organizëm, gjembi i gomarit, anginarja çikorja rregullojnë metabolizmin e përmirësojnë punën e mëllçisë. Bimë që përmbajnë Betasitosterole dhe sitostanole, si majdanozi dhe kanella ndikojnë në tretje dhe pastrojnë enët e qarkullimit të gjakut. Vaji i Lirit me dozat 5-10 ml në ditë ndihmon tretjen dhe jashtëqitjen njëkohësisht ndikon në largimin e LDL nga organizmi. Si përfundim nëse kolesterolit të keq me vlerat mbi 220mg/dcl i shpallni një luftë të heshtur për rreth një muaj atëherë ju dilni fitimtar mbi arterosklerozën.





# 10 këshilla të thjeshta për të luftuar pagjumësinë

**N**e shpenzojmë një kohë të madhe të jetës duke fjetur. Foshnjat flenë praktikisht 24 orë në ditë. Fëmijët e vegjël bëjnë dremitje të vogla. Të rinjtë dhe adoleshentët flenë nga 8-9 orë në natë, ndërsa të rriturit flenë 7-8 orë ose edhe më pak. Shumë persona më të moshuar kanë nevojë për më pak orë, ndoshta 5 ose 6 dhe, gjithashtu, kanë tendencën për ta pasur gjumin shumë të lehtë. Personat në moshë të thyer, ndoshta nuk kanë nevojë të flenë shumë ose janë të aftë të flenë po aq sa edhe të rinjtë. Kjo mund t'i dedikohet stilit të jetesës sepse ata flenë më shumë gjatë ditës, për shkak të kohës së lirë. Gjumi i ditës i bën ata të mos flenë natën. Termi pagjumësi i referohet paaftësisë për të fjetur ose për të qëndruar në gjumë për një kohë të gjatë. Kjo mund të shkaktojë lodhje të vazhdueshme dhe ndikon shumë negativisht në jetën tuaj të përditshme.



Studimet e fundit kanë treguar se nuk është i pakët numri i personave që vuajnë nga pagjumësia, ata përbëjnë 39% të popullsisë. Stresi, depresioni dhe shqetësimet janë shkaqet kryesore që çojnë në pagjumësi. Sëmundjet e ndryshme janë një tjetër shkak i mundshëm dhe veçanërisht nëse ka dhimbje apo siklet. Përpara se të vendoset për trajtimin e pagjumësisë, është e rëndësishme që të identifikohen faktorët mjekësorë dhe psikologjikë, të cilët mund të jenë shkaktarët e vërtetë të kësaj situatë. Trajtimet medikamentozë rekomandohen përgjithësisht për zvogëlimin e simptomave të pagjumësisë akute, ndërsa roli i tyre në menaxhimin e pagjumësisë kronike mbetet jo shumë i qartë. Ndaj në çdo rast duhet të bëhet shumë kujdes me përdorimin e tyre pa kriter. Përgjithësisht pilulat e gjumit nuk rekomandohen për përdorim afatgjatë. Është e rëndësishme që fillimisht të identifikohen problemet shëndetësore që kontribuojnë në pagjumësi, të tilla, si: depresioni, sëmundjet e aparatit të frymëmarrjes, si edhe dhimbjet kronike. Për sa i përket

trajtimeve jofarmakologjike vlen të përmendet hipnoza, e cila mund të ketë efekte të gjata e të qëndrueshme. Gjithashtu, ka të dhëna se edhe meditimi luan një rol shumë pozitiv. Më poshtë po listojmë disa këshilla të thjeshta, se si mund të veproni për rikthimin e gjumit, duke ndihmuar kështu organizimin që të jetë i shëndetshëm dhe të përballojë më lehtë të gjitha problemet, apo vështirësitë që shfaqen në kryerjen e aktiviteteve të përditshme.

**1. ORARI I GJUMIT**  
Rekomandohet të shkoni në të njëjtën orë në shtrat për të krijuar oraret e reflekseve të rregullta të gjumit.

**2. ZGJIMI NATËN**  
Nëse ju del gjumi natën mos u ngrini ose mos hapni televizorin, mos shikoni orën se sa është, por qëndroni në shtrat dhe përpiguni të flini (mund të numëroni ose të kryeni veprime matematike me mend derisa t'ju mundë gjumi).

**3. PUSHIMI I DREKËS**  
Mos u shtrini për pushimin e drekës pas orës 15:00, dhe jo më shumë se tridhjetë minuta, maksimumi një orë.

**4. MËNYRA E USHQYERJES**  
Asnjëherë mos flini me barkun plot, hani darkë të paktën dy orë para se të shtrihen. Edhe shëtitjet para gjumit janë dobisjellëse. Një ushqyerje e shëndetshme është

të gjithmonë pozitive.

**5. AKTIVITETET SPORTIVE**  
Marrja me aktivitete sportive ndihmon shumë në një gjumë të rehatshëm. Mjaft pozitive janë kur bëhen afër kohës së gjumit.

**6. DHOMA E GJUMIT**  
Bëni kujdes që të kenë një dyshek dhe krevat të rehatshëm për trupin tuaj, hiqni nga dhoma sende që bëjnë zhurmë si për shembull tik-taku i orës, mbani grilat ulur për të minimizuar zhurmat nga jashtë.

**7. KUJDES ME KAFEN**  
Mos pini shumë kafe gjatë ditës dhe sidomos jo pas orës 16:00, si dhe mos abuzoni me alkoolin e konsumin e duhanit.

**8. PILULAT E GJUMIT**  
Kryesore janë këshillimet me mjekun tuaj, por edhe me psikologun. Kujdes, mos blini kurrë pilulat gjumi në farmaci pa këshillimin e mjekut.

9. Përdorimi i medikamenteve  
Duhet të bëni kujdes me përdorimin e medikamenteve. Përgjithësisht pilulat e gjumit nuk rekomandohen për përdorim afatgjatë.

10. Rrini të qetë  
Kontrolloni stresin. Kur kenë shumë gjëra për të bërë dhe shumë gjëra për të menduar, gjumi është ai që e pëson i pari. Që të vendosni qetësinë në jetën tuaj, keni parasysh mënyra për ta kontrolluar stresin.





# Këshilla



## Luftoni kolesterolin e lartë me domatet jeshile

**D**omatja është një nga produktet që prodhohet së shumti në vendin tonë, pa të cilën shumë prej gatimeve tona nuk do të kishin kuptim. Por, gjithashtu, njihet edhe për vlerat e shumta shëndetësore që ka. Domatet jeshile përmbajnë shumë vitaminë C dhe më shumë ujë e janë të pasura me kalcium, hekur, magnez, fosfor, kalium, sodium dhe zink. Substancat e domateve jeshile janë të ngjashme me acidin acetilsalicilik që hollon

gjakun dhe njerëzit që vuajnë nga varçetet mund t'i përdorin si një terapi alternative ndaj holluesve të gjakut. Fetat e domateve jeshile mund të vendosen mbi varçete dhe të mbahen për 20 minuta.

Kjo procedurë duhet të përsëritet disa herë për rezultate maksimale, e si pasojë varçetet do të zhduken gradualisht. Domatet jeshile përmbajnë flavonoidë dhe vitaminë A që luftojnë radikalet e lira. Këto të fundit prodhohen gjatë ekspozimit të gjatë ndaj rrezeve ultra vjollcë dhe pa-

jisjeve elektronike. Konsumi i mjaftueshëm i domateve jeshile ndihmon në minimizimin e nivelit të radikaleve të lira në organizëm. Gjithashtu këto perime përmbajnë mjaftueshëm proteinë, vitaminë B3 dhe yndyra të mira që luajnë një rol thelbësor në uljen e kolesterolit si dhe kanë bioflavonoide që luftojnë bakteret dhe inflamacionin në organizëm. Në këtë mënyrë ato përshpejtojnë shërimin nga inflamacioni dhe zbusin dhimbjet që e shoqërojnë atë. Sipas të dhënave në 100 gramë domate jeshile gjenden 23.4 mg vitaminë C e cila rigjeron qelizat e lëkurës dhe parandalon shfaqjen e rrudhave të para në lëkurë. Për më tepër, vitamina A dhe kaliumi ruajnë freskinë e lëkurës dhe e bëjnë atë më të tendosur. Domatet jeshile përmbajnë karbohidrate, fibër, proteinë dhe sheqerna që i japin organizmit ushqyesit dhe energjinë e nevojshme. Në të njëjtën kohë, domatet ulin sasinë e yndyrave të këqija në organizëm që nxisin akumulimin e dhjamit. Domatja jeshile përmban tomatidinë, një përbërës që nxit formimin e qelizave muskulare dhe mbron masën muskulare. Por këto kokra i bëjnë mirë edhe shëndetit të syve pasi përmbajnë vitaminë A, e cila është vitamina kryesore për mbrojtjen e cilësisë së shikimit.



## Konsumoni çaj me gjethe manaferre për një zemër të fortë

**M**anaferra, është një frut pylli plot me përfitime shëndetësore, por edhe gjethet e saj ofrojnë shumë vlera duke qenë se janë të pasura me flavonoidë, vitamina dhe antioksidantë. Këto gjethe konsiderohen si tepër të çmuara në mesin e kurave të ndryshme bimore e janë të rëndësishme për trajtimin e një sërë problemesh shëndetësore. Lëngu dhe çaji i manaferrës është një prej mënyrave për të përfituar këto vlera pasi është i pasur me flavonole që ndihmojnë në mbrojtjen e zemrës. Kështu çaji i manaferrës mundet të parandalojë rrezikun e sëmundjeve të zemrës, siç është arteroskleroza. Fibra dhe magnezi tek manaferrat kanë një ndikim të rëndësishëm në qarkullimin e gjakut, rregullojnë tensionin e gjakut dhe parandalojnë aritminë. Një tjetër vlerë e çajit të manaferrës është mbrojtja e kockave. Ky çaj përmban minerale të dobishme siç janë kalciumi dhe magnezi të cilat janë thelbësore për mirëmbajtjen e kockave. Ekspertët konfirmojnë se kalciumi tek manaferrat forcon kockat ndërkohë që magnezi ndihmon në përthithjen e këtij minerali por edhe të kaliumit. Kalciumi tek manaferrat i bën kockat më të forta dhe mbron funksionet e qelizave. Disa studime kanë treguar se fibra e tretshme dhe e patretshme që gjendet tek manaferrat dhe gjethet është dobishme për sistemin tretës. Fibrat stimulojnë përthithjen e ujit në zorrën e trashë. Pirja ditore e çajit të manaferrës dhe gjetheve të tij është një zakon i mirë për mbrojtjen e shëndetit të syve. Përbërësit e tyre janë të dobishëm në pakësimin e dëmeve të shkaktuara nga rrezet ultravjollcë. Çaji i manaferrës dhe gjetheve të saj përmban antioksidantë, por edhe vitaminat E dhe C. Siç e dini, vitamina E luan rol kryesor në mirëmbajtjen e shëndetit të lëkurës dhe pakësimin të rrudhave. Gjithashtu ky lloj çaji është i dobishëm në përmirësimin e funksioneve njohëse të trurit dhe trurit. Frutat e pyllit kanë në përgjithësi nivel të lartë antioksidantësh. Çaji i manaferrës është gjithashtu i pasur me antioksidantë të cilët mbrojnë trupin në një sërë mënyrash. Për të përgatitur çajin duhet të merrni 5-6 gjethe manaferre dhe ti lani mirë, e më pas ti zieni në 100 ml ujë. Kullojeni lëngun dhe ekstrakti i gjetheve të manaferrës është gati për përdorim.

## PËRKUJTIMI

# GJON RADOVANI: Memoriali për fëmijët e vdekur në Kampin e Tepelenës

Në përgjigje të interesit të shumë qytetarëve dhe institucioneve që nuk kanë pasur mundësi të njihen deri tani me projektin e Memorialit të Fëmijëve të Vdekur, që po ndërtohet në kompleksin muzeal të Kampit të Internimit në Tepelenë, iniciuar nga AIDSSH dhe projektuar nga arkitekt Gjon Radovani, arkitekti dhe MEMO japin më shumë detaje rreth tij.

Radovani e nis sqarimin me informacionin se në kampin e Tepelenës kanë ndërruar jetë rreth 300 të mitur, kryesisht nga uria dhe nga keqtrajtimi i përgjithshëm që u bëhej të internuarve. "Këta fëmijë përfunduan në këtë qendër brutale internimi, sepse kishin të vetmin 'faj' të ishin fëmijë ose nipa të prindërve, gjyshave, kushërinjve, që për Pushtetin Popullor ishin kategorizuar si armiq të klasës. Në të shumtën e rasteve kjo ndodhte vetëm për faktin, sepse ishin familje të pasura, por kishte edhe raste që ndonjë anëtar i këtyre familjeve ose ishte shprehur hapur kundër dhunës komuniste, ose ishte arratisur në shtetet fqinje. Këtyre fëmijëve u është hequr edhe e drejta e të pasurit një varr, duke i varrosur buzë të lumit, me qëllim që ujërat e lumit të merrnin me vetë eshtrat duke zhdukur gjurmët e këtij makabriteti të programuar shtetëror", thotë ai.

Kazermat dhe ndërtesat e kompleksit "rrethojnë" një oborr pothuajse katror. "Në mesin e këtij katrori me brinjë prej 131 m propozohet të vendoset instalacioni në kujtesë të këtyre genieve të pafajshme, që ndërruan jetë në situata çnjerëzore. Për të hequr çdo lloj patetizmi dhe çdo lloj eksklamacioni të dëmshëm dhe antiproduktiv në transmetimin e historisë dhe të ndjenjës së dhunës dhe për pasojë, të dhimbjes njerëzore, propozohet që këta fëmijë në instalacion të përfaqësohen nga qiparisat (cupressus sempervirens Bolgheri), pemë të cilat sigurojnë gjelbërim për gjithë vitin, tregojnë në mënyrë të pangatërrueshme lidhjen me qiellin dhe personifikojnë elegancën dhe brishtësinë e fëmijëve në formë", shton Radovani.

Sipas tij, këto qiparisat do të krijojnë një katror tjetër në qendrën e oborrit, katror me brinjë 54 m. Ato qëndrojnë 3 m larg njëri-tjetrit (masë aksiale në të dy drejtimet) dhe vihen në rreshta duke ngushtuar katrorin e jashtëm, për t'u ndalur pas gjashtë rreshtave dhe për të krijuar një katror të brendshëm vakumi shpirtëror dhe hapësinor me përmasa 18 x 18 m.

Radovani vë në dukje se ky min-



"Instalacioni distancohet në mënyrë të dukshme e të qëllimshme nga kapanonet rrethuese"

ishesh i brendshëm që do të jetë sheshi i qetësisë, i meditim, i përpunimit të dhimbjes dhe të brutalitetit njerëzor, do të jetë i shtruar nga një pllakë graniti me ngjyrë antracid në të cilin do të gdhenden emrat e fëmijëve të zhdukur. Platforma e granitit "paloset" në ekstremitetet e saj duke krijuar në mënyrë krejt natyrale dhe të pazhurmshme vende uljeje për vizitorët. Për të arritur në këtë shesh nuk ka një rrugë të shënuar.

Sipas tij, e vetmja mundësi aksesibiliteti është kalimi mes këtij "pylli" qiparisash me qëllim që vizitorët të ndiejnë praninë e qiparisave tek shkojnë në shesh, ato duhet të "miqësohen" me përfaqësuesit e viktimave për të arritur në platformën e qetësisë.

"Në këtë platformë kujtimi dhe meditim humbet edhe kontakti viziv me kazermet rrethuese të kampit. Vetëm aty qetësia shpirtërore mund të shpalojë e mbrojtur nga ambienti rrethues, nga dielli përvëlues nga pamja e trishtë e makinerisë së shkatërrimit të dinjitetit njerëzor. Vizitorët mund/duhet të ecin mbi emrat e fëmijëve dhe të ndiejnë efektin që krijon për një qenie njerëzore, qoftë edhe përbaltja dhe shkelja e emrave të gdhendur. Në këtë shesh të rrethuar nga qiparisat ato mund të shohin vetëm emrat e të zhdukurve dhe qiellin, kulisë perfekte për të ndier shpirtërisht dhe përpunuar historinë e dhimbshme të këtij kampi shfarosjeje", thotë Radovani në

vijim të idesë së tij.

Forma bazë e zgjedhur për ndërtimin e memorialit është një

formë qëllimisht ortogonale (rrethojnë e sistemit kartezian), forma bazë e krijuar nga gjeniali-

teti i mendjes njerëzore. Vetëm një formë thellësisht njerëzore do të ishte e përshtatshme për të përshkruar ferrin njerëzor (në antag-onizëm me formën rrethore të ferrit dantesk). "Katrorët e qiparisave që brendashkruajnë njëri-tjetrin janë gjashtë, sepse i shtati mungon. I shtati shërben për të krijuar vakumin e sheshit të meditim. Është pikërisht dita e shtatë e krijimit, misioni i ditës së shtatë të javës, që këtyre viktimave foshnja të pafajshme u është hequr nga dhuna njerëzore. Për paradoks dhe për besim në të mirën e njerëzimit, pikërisht ajo që u është privuar viktimave, krijon edhe shpresën e një bote më të mirë, më të ndërgjegjshme dhe më në respekt të dinjitetit të njeriut", thekson Radovani.

Sipas tij, ky instalacion i vendosur në qendrën e sheshit të kampit distancohet në mënyrë të dukshme e të qëllimshme nga kapanonet rrethuese. Kjo nga njëra anë, sepse "përbuz" dhunën e përdorur në këto struktura diabolike dhe nga ana tjetër, për të mos ndërrhyrë në emocionet e vizitorëve që vëzhgojnë artefaktet e ekspozuar në këto kapanone.

## Debati/ "Pse të internuarit marrin nderim nga komunistët?"

Osman Kaceli: Le ta marrim atë vlerësim nga armiqtë

Fatmira Nikolli

Në orën 18.30 të datës 23 gusht (Dita Ndërkombëtare e Përkujtimit të Viktimave të Komunitetit e Nazizmit), Presidenti i Republikës, Ilir Meta, mbërriti në Kampin e Tepelenës dhe në prani të të mbijetuarve e familjarëve të tyre, përfaqësuesve të institucioneve publike e lokale, shoqatave të të drejtave të njeriut, përfaqësuesve të të gjithë spektrit politik, organizatave ndërkombëtare dhe të rinjve të pranishëm, dekoroi për "Merita të veçanta civile", të mbijetuarit: Gjellë Gjikota dhe Mrikë Gjikota (Age Totaj, e bija tërhoqi titullin); znj. Drane Jakja (pas vdekjes), (Nikë Vuksani, i biri tërhoqi titullin) dhe z. Lek Pervizi, që ka

sjellë dëshmi të gjalla deri në të sotmen, duke përdorur thëngjill e laps për të dokumentuar me saktësi akribike figura, ndërtesa, situata, portrete dhe njerëz, pa i interpretuar, me qartësinë dhe besnikërinë e një fotografie.

Ajo që ndodhi më pas, që renditja e pikëpyetjeve të mëdha, normale në një shoqëri të shëndoshë, por edhe në një shoqëri që rropatet për të qenë e tillë. Çdo pikëpyetje që ngrihet është normale dhe meriton përgjigje. Disa përgjigje. Meriton mendime. Disa mendime. Ato për një rend ideologjik që ndryshoi rrjedhën e vendit, edhe më shumë. Prej dekorimit, pyetja kryesore e shprehur në mënyrë të ndryshme që kjo: pse të internuarit marrin nderim nga komunistët? E shprehur në mënyrë të ndryshme e në forma të ndryshme, pa përcaktuar se kush ishte komunisti a

komunistët, ajo që kërkohet të vihej në dukje që: C'na duhen dekorimet, kur askush nuk është vënë para drejtësisë? Kur kemi përfunduar në gjyq kafesh? Kur dekomunistizimi nuk ia ka dalë? Kur komunistët e bijtë e tyre, thjesht kanë ndërruar parti e sistem? Kur në fund, edhe ne që kishim vuajtur edhe ata që na bënë të vuajmë, jemi



## PËRKUJTIMI

# “Epoka e Pluhurit”, për herë të parë në Muzeun Arkeologjik në Tiranë

Eleni Laperi\*

**K**a shumë arsye pse njeriu mund të mbetet pa fjalë për një kohë, duke rënë në një gjendje trishtimi pa ngushëllim. Këtë dhimbje emocionale, të lidhur me ndjenjat e humbjes, dëshpërimit, pikëllimit, pafuqisë, zhgënjimit dhe pikëllimit i provova sot pas një vizite në Muzeun Arkeologjik në Tiranë.

Muzeu Arkeologjik i Tiranës i ngjan një magazine të harruar, ku gjithë objektet janë të mbuluara nga një pluhur, që në gjuhën popullore do ta cilësonin “një gisht të trashë”. Po që të më kuptojnë gjithë ata “Prof.Dr.” që punojnë në zyrat e Institutit të Arkeologjisë dhe Akademisë së Shkencave të Tiranës, do të them se objektet ishin të mbuluara nga një pluhur prehistorik.

Ja si cilësohet Muzeu Arkeologjik në faqen web të Bashkisë së Tiranës:

“Muzeu Arkeologjik i Tiranës ndodhet në Sheshin Nënë Tereza në Tiranë. Është i pari muze i krijuar pas Luftës së II Botërore. U hap më 01.11.1948 si Muze Arkeologjik-Etnografik dhe vazhdoi i tillë deri në vitin 1976, kur u veçua pavioni etnografik dhe ai u organizua si muze i profilizuar arkeologjik. Muzeu Arkeologjik prezanton kërkimet e zbulimet arkeologjike në të gjithë territorin e Shqipërisë. I vendosur në të njëjtën



“Pamje sa një mijë fjalë”, ‘Prof.Dr’ janë veç një formë e re e ‘spahijve timarli’”

godinë me Institutin e Arkeologjisë dhe Akademisë së Shkencave të Tiranës, muzeu shfaq vlera arkeologjike të hershme deri në Mesjetë. Konsiderohet muzeu mëmë për gjithë muzeumet e tjera të këtij lloji në vend përfshi dhe Muzeun e Durrësit. Biblioteka e tij ka 7200 vëllime.”

Dhe ja çfarë thuhet për të në Wikipedia:

“Muzeu Arkeologjik Kombëtar në Tiranë e ka zanafillën në vitin 1948 me emërtimin Muzeu Etnografik-Arkeologjik. Me zgjerimin e kërkimeve dhe studimeve

në vitin 1976 u kthye plotësisht në muze arkeologjik.

Aktualisht, është qendra ku pasqyrohet pjesa më e madhe e pasurisë arkeologjike në vend. Muzeu numëron rreth 18 mijë objekte, të cilat i takojnë periudhave të ndryshme historike, ndërkohë që në tri pavijonet e tij janë ekspozuar mbi 2000 objekte ku përfshihen skulptura dhe deri tek objekte

të imta, të cilat i takojnë epokës së gurit deri në pushtimin turk.

Një pjesë e objekteve nuk ekspozohen për shkak të mungesës së ambienteve ndërsa pjesa tjetër ka vlera të vogla ekspozimi. Kurse në faqen <http://www.studentofstory.com/> thuhet, ndër të tjera:

“Kërkimet intensive arkeologjike në fushën e prehistorisë, antikitetit dhe mesjetës gjatë viteve në vazhdim bënë të mundur një varg riorganizimesh e rikonstruksionesh të këtij muzeu (1957, 1976, 1982, 1985, 1998) për përmirësimin e mëtejshëm të përmbajtjes dhe ekspozimit. Ky muze jep një informacion të plotë për vendbanimet më të hershme në Shqipëri e veçanërisht për periudhat ku zhvillohen proceset e formimit të fiseve dhe etnosit ilir: Muzeu Arkeologjik i Tiranës është i pari muze i krijuar pas Luftës së II Botërore, pasi gjatë kësaj lufte u shkatërruan edhe institucionet e fundit muzeale. U hap më 01.11. 1948 si Muze Arkeologjik-Etnografik dhe vazhdoi i tillë deri në vitin 1976, kur u veçua pavioni etnografik dhe ai u organizua si muze i profilizuar arkeologjik. Ky muze prezanton kërkimet e zbulimet arkeologjike në të gjithë territorin e Shqipërisë. Materiali i ekspozuar përfshin një periudhë kohore nga epokat e gurit, tek ato të metaleve (bronzit e hekurit) kur lindi e u zhvillua qytetërimi ilir, periudhën e antikitetit ilir (dhe jo vetëm), dhe periudhën e antikitetit të vonë e mesjetën deri në pushtimin osman.”

Ky ‘muze mëmë’, sipas faqes së Bashkisë të Tiranës, ky muze që ‘Jep një informacion të plotë për vendbanimet më të hershme në Shqipëri e veçanërisht për periudhat ku zhvillohen proceset e formimit të fiseve dhe etnosit ilir’, të bën për të qarë.

bashkëfajtorë? Kur duan ta fshijnë çka ndodhur, ose kur flasin çka ndodhur me lehtësinë e papërbalueshme të një bisede për prehistorinë? Kur strehohen te komunizmi për t’i ikur debatit të ditës? Kur u “përlulen” viktimave që të mos i përlulen kundërshtarit?

Pra, pas gjithë kësaj shtirjeje, pse duhej një vlerësim?

Dekorimi i të mbijetuarve të regjimit, me gjithë dëshirën e mirë, u pa si një veprim që krahasohet me lyerjen e të sëmurit që të mos duket i zbehtë, por pa e luftuar sëmundjen dhe atë që e krijoi virusin.

E kam lexuar këtë debat, me



interesin e një njeriu që rreket të kuptojë se sa duron njeriu. Me interesin e një njeriu që rreket të kuptojë se cilat pyetje shtrohen. Me interesin e një njeriu që kërkon të njohë debatin në parim, pa u përqendruar në emra e detyra. Sepse nëse një vend duhet ndryshuar duhet nisur nga idetë jo nga emrat. Sistemi përbëhet nga idetë dhe nga format e zbatimit të tyre.

Mes dyzimit se e drejta jo gjithnjë shkon për një palë, një përgjigje që disi vlen të vihet në dukje është ajo e Osman Kacelit.

Ai është djali i Jonuz Kacelit, një tregtar që mes të tjerash prodhoi kartolinat e para shqiptare. Qe dënuar për bombën në ambasadën sovjetike.

Duke qenë mes atyre që e vuanjtën në supet e tyre regjimin e pasi e ka ndjekur debatin, ai shkruan se “në nderimin e të mbijetuarve mbi 90-vjeçarë të Tepelenës, ai përfaqësoi Institutin e Presidencës së Republikës! Lekë PERVIZIT iu dha ajo medalje. ‘Për merita të veçanta civile’. Ky në limitet e mundësive reale, ka vizatuar me copa letre, me kapakë fletoresh e me thëngjij qymyri, tmerret e papërshkrueshme të kampit të shfarosjes së Tepelenës. E jo vetëm atë, por i ka rrujtun me fanatizëm dhe në fshehtësi maksimale edhe mbas vitit 1954, kur ky kamp shfarosje u mbyll i përfundimisht”. Shton për Per-

vizin, se “me lirinim mbas 44 vjet interinimi të randë e të vazhdueshmë në 1991, ai u vendos në Belgjikë, ku me iniciativë personale, botoi revistën ‘Kuj e Zi’, që e vazhdon edhe sot e kësaj dite. Aty ai gjeti mundësi t’i botojë edhe ato vizatime e dizenoje të çmuara, që më vonë u përmbledhën në një katalog, me iniciativë të Agron Tufës, Drejtori i ISKPK!”

E mandej ka një përgjigje për shumëkënd kur thotë: Nëse unë, ti Syrja Cela, Tommy Agolli, Adriani, Ilir Cela, Sami Duka, Edmond Bermema, Billi, Hasan Qesja si dhe të gjithë polemistët e tjerë, do të kishim pas këto merita, nuk do t’i kishim rezistit tentacionit, për ta pas atë vlerësim edhe nga armiqitë. Doket tona zakonore e pranojnë edhe nderimin nga armiku dhe anasjelltas e nderojnë atë në rast kur e meriton. Po kështu jam i bindur se edhe nonat apo motrat tona po të kishim kry aktin sublim të Gjëlë e Mrikë Gjokolës dhe Drane Jakjes, do ta kishim pranuar atë vlerësim të naltë! Lexoni të nderuemin Meti Fidanit, për të njoft aktin e tyne sublim!”

A kanë marrë përgjigje pyetjet? Me gjasë jo, por Autoriteti i Dosjeve bën sa mundet për të kujtuar ata që u shuan duke lënë emrat e tyre nëpër dosjet e Sigurimit.

Se nëse profesorët tanë e lënë ashtu edhe ‘mëmën’ e tyre dhe i japin publikut në atë formë ‘informacionin’ e pluhurosuar për qytetërimin tonë, do të thotë se ata burra me tituj nuk kanë aspak respekt për materialet, që u kanë dhënë titujt, që i ekspozojnë me krenari nëpër dyert e zyrave, ndërkohë që etiketat shpjeguese të objekteve muzeale janë të pluhurosura e të zverdhura nga vjetërsia.

Nga një vizitë në atë muze kupton se gjithë ata ‘Prof.Dr.’, që i kanë të ngjitur në etiket të pastra e të bukura emrat e tyre në radhën e gjatë të dverve të atyre zyrave në katin e dytë të Muzeut Arkeologjik, nuk zbresin fare në sallat ku janë ekspozuar objektet e vjera të historisë e kulturës sonë, jo për të organizuar ndonjë bisedë për publikum, (kjo do ishte tepër), po as për të hedhur një sy mbi ato objekte të vjera, të lëna në një mjerim ngjethës e në mëshirë të pluhurit.

Sepse stendat e atij muzeu, janë aq të pluhurosura sa mezi i dallon linjat e skulpturave dhe me vështirësi lexon atë pak shpjegim që të japin etiketat, kurse shtatorët kryevepra ngrihen të renditura në dyshtemenë e shtruar me një linoalum të një epoke të papërcaktuar, apo të shohin me sytë e zbraزت nga ca mbajtëse të montuara në muret e lyer me një ngjyrë të shëmtuar rozë.

Dhe të mendosh se kanë shembuj të hershëm se si mbahet e si funksionon një muze arkeologjik që në vitet 1920, kur qeveria shqiptare i propozoi ballkanologu austriak Carl Patsch, të drejtonte muzeun e parë arkeologjik në Shqipëri. Ndryshe nga këta profesorë e Akademisë sonë, të cilët nuk ua hedhin sytë pasurive një kat poshtë zyrave të tyre, që i japin titujt, 100-vjet më parë austriaku Patsch, si profesionist që respekton degën e profesionit të tij, ndërtoi një program të qartë dhe serioz për muzeun e arkeologjisë shqiptare.

Muzeu Arkeologjik i Tiranës është ‘pamje sa një mijë fjalë’, që të bind se gjithë këta ‘Prof.Dr.’, të cilët kanë zyra me etiketa të bukura në katin e dytë të atij muzeu, janë veç një formë e re e ‘spahijve timarli’, me të vetmin ndryshim se ‘timarli’ i tyre sot, ai që u siguron të ardhur të mira e titujt, është vetëm studimi i ndonjë dege të shkencës së arkeologjisë apo albanologjisë. Për këtë arsye këtyre ‘spahijve timarli’ të sotëm, ashtu si atë të shekujve të shkuar, as që u bëhet vonë për pluhurin që mbulon vitrinat e veprat e artit të Muzeut Arkeologjik. Si spahijve timarli të dikurshëm, atyre nuk u intereson promovimi i kulturës e i përparimit të kombit tonë në shekuj, pasi janë të interesuar vetëm për të ardhurat që u sjell ‘timarli’ i tyre, në karrierën e tyre akademike, në titujt dhe të ardhurat, që ajo u siguron.

(\*Kritike Arti. Marrë nga blogu i saj)

Dje në "Evropa e Lirë"

# Korrigjimi i kufijve e fshin Kosovën nga Kushtetuta e Serbisë

Nga Bekim Bislimi

(vijon nga faqja 1)

... të zhvillimeve politike dhe ekspertë të çështjeve juridike.

Pavarësisht nga kjo, në qeverinë e Serbisë, në Zyrën për Kosovën të kësaj qeverie e as në Kuvendin e Serbisë, nuk ka informacione se dikush po merret me këtë çështje.

Ministria e Drejtësisë e Serbisë, përmes një deklarate me shkrim për Radion 'Evropa e Lirë', ka thënë se ajo merret ekskluzivisht me amendamentet kushtetuese që ndërlihen me gjyqësorin.

Nga qeveria e Serbisë është thënë për Radion Evropa e Lirë se askush nuk është duke u marrë me ndryshimin e Kushtetutës në lidhje me Kosovën, ndërkohë që Zyra për Kosovën e qeverisë së Serbisë, nuk është përgjigjur fare.

Edhe më tej, në fjalorin zyrtar të zyrtarëve serbë, Kosova është "krahina jugore serbe", ndonëse, faktikisht, nuk është e tillë gati se tash e dy dekada.

Kushtetuta e tanishme serbe thotë se Kosova është pjesë e Serbisë, ndërkajq që kufijtë, pas vitit 1999, prej kur institucionet e shtetit të Serbisë nuk janë të pranishme më në territorin e Kosovës, i quan si kufij administrativ. Çdo ndryshim do të nënkuptonte edhe ndryshim të Kushtetutës së Serbisë.

Gordana Çomiç, nënkryetare e Këshillit parlamentar për çështje kushtetuese dhe legislative, thotë se nuk ka njohuri që ndonjë institucion apo ekip profesional po merret me dispozitat kushtetuese për Kosovën.

"Kjo nuk është temë as në opinionin tonë vendor, as në opinionin evropian e as në vendet partnere ku merren vendimet, sikurse që janë Moskë ose Uashingtoni. Kushtetuta dhe preambula askund dhe për askënd nuk janë temë", thotë Çomiç.

Megjithatë, bashkëbiseduesit e 'Radios Evropa e Lirë', vlerësojnë se do të ketë mjaft punë lidhur me këtë çështje.

Bogoljub Milosavljeviq, profesor i të Drejtës Kushtetuese nga Beogradi, thotë se Kosova duhet të largohet nga Kushtetuta serbe në qoftë se vendosen kufijtë me Serbinë.

"Kaktimi i kufijve, në kuptimin e pranimt të pavarësisë shtetërore të Kosovës, kurrë nuk do të mund të bëhet pa ndryshimin e Kushtetutës. Së pari, ajo pjesë në të cilën thuhet që Republika e Serbisë ka në përbërjen e saj dy krahina autonome, Vojvodinën dhe Kosovën. Edhe preambula e Kushtetutës do të duhet të pësonte ndryshime, marrë parasysh që ajo u krijon organeve shtetërore obligime të cak-



tuara lidhur me Kosovën", -shpjegon procesin Milosavljeviq.

Në Kushtetutën e Serbisë, të vitit 2006, Kosova përmendet në mënyrë eksplicite tre herë. Fillimisht në preambulë, më pas në nenet për organizimin territorial, në të cilat definohet pozita e krahinave autonome. Preambula në të cilën përmendet Kosova, nuk është pjesë obliguese e Kushtetutës.

Se a do të duhet që kjo preambulë të ndryshohet apo të fshihej tërësisht, ekzistojnë qëndrime të ndryshme në opinionin e ekspertëve.

Në pjesën normative të Kushtetutës serbe, Kosova duhet të fshihet tërësisht, shpreh mendimin Dushan Janjiq nga Forumi për Marrëdhënie Etnike.

Kushtetuta e tanishme serbe thotë se Kosova është pjesë e Serbisë, ndërkajq që kufijtë, pas vitit 1999, prej kur institucionet e shtetit të Serbisë nuk janë të pranishme më në territorin e Kosovës, i quan si kufij administrativ. Çdo ndryshim do të nënkuptonte edhe ndryshim të Kushtetutës së Serbisë.

"Duhet që nga ligjet e Serbisë dhe sistemi kushtetues, të përjashtohet fjala Kosovë. Sidoqoftë, nuk ka shumë ndryshime në vetë tekstin e Kushtetutës së vitit 2006", -theksoi Janjiq.

Shënimi i kufijve me Kosovën, për të cilën po flasin kryetari i Serbisë, Aleksandar Vuçiç dhe bashkëpunëtorët e tij, si një zgjidhje e mundshme, nënkupton përcaktimin e kufijve me Kosovën. Në nenin 8 të Kushtetutës së Serbisë thuhet që territori i Serbisë është "unik dhe i pandashëm", ndërkajq që kufiri është "i paprekshëm".

Përcaktimi i kufijve nuk është pjesë e Kushtetutës. Kufijtë përcaktohen me marrëveshje ndërkombëtare dhe precizohen me komisione të përziera në rast se nuk ka

konteste të mëdha, sqaron Janjiq. "Kur kjo të caktohet, kur kjo marrëveshje të vërtetohet, jo vetëm me nënshkrimet e (presidentit të Kosovës, Hashim) Thaçi dhe (presidentit të Serbisë, Aleksandar) Vuçiç në Bashkimin Evropian, por edhe me verifikimin përmes Këshillit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, kjo nënkupton që më nuk do të vlejë Rezoluta 1244 e Kombeve të Bashkuara. Atëherë duhet qasur procesit të demarkacionit. Demarkacioni është procedurë, e cila nuk është e definuar me Kushtetutë, por që është e definuar me normat ndërkombëtare dhe më tepër është punë teknike për qeveritë e Kosovës dhe të Serbisë", - sqaroi Janjiq.

Shënimi i kufirit me Kosovën, çfarëdo qoftë që nënkupton ai, bëhet përmes procedurës së caktuar kushtetuese, thotë profesori Bogoljub Milosavljeviq. Sipas tij, duhet të silltet vendimi me dy të tretat e votave në Kuvendin Popullor dhe konfirmohet në referendum.

Milosavljeviq thotë se Kapitulli 35, në negociatat për pranimin e Bashkimin Evropian, nënkupton që të gjitha çështjet e hapura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë du-

het të definohen para hyrjes në Bashkimin Evropian.

Gjithashtu, sipas tij, pranimi i Serbisë që Kosova ta marrë ulësen në Kombet e Bashkuara, nënkupton që të mos kontestohet statusi i Kosovës si shtet i pavarur, që do të thotë edhe caktimin e kufijve ndërmjet tyre.

"Të gjitha këto do të mund t'i dinim në momentin që jemi në gjendje që të shohim të ashtuquajturin akt juridik obligues, se çfarë zgjidhje parashihen - se a bëhet eventualisht fjalë për ndonjë kaktim të kufijve sipas kufirit të tashëm administrativ ose që eventualisht bëhet fjalë për ndonjë ndryshim të kufirit administrativ", -theksoi Milosavljeviq.

Sidoqoftë, Aleksandar Vuçiç, kur ka marrë detyrën e presidentit të Serbisë, në Kuvendin e Serbisë, me 31 maj të vitit 2017, është betuar, duke thënë se të gjitha fuqitë e tij "do t'ia përkushtojë ruajtjes së sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Republikës së Serbisë, duke përfshirë edhe Kosovën si pjesë të saj".

Se si do të duket betimi i presidentit të Serbisë, pas zgjedhjeve të ardhshme për president në këtë vend, mbetet të shihet.

Radio Evropa e Lirë (vll)

Opinioni **i** Ditës

# A ndikon ndarja në zgjidhjen e problemit Kosovë-Serbi?

Në botën akademike janë shkruar artikuj që merren me pyetjen nëse ndarja etnike mund të ndihmojë në dhënien fund të luftës dhe zvogëlimin e rreziqeve për rikthimin e saj. Një nga akademikët është Jonah Schulhofer-Wohl.

Deutsche Welle: Debatimi për ndarjen territoriale si zgjidhje për konfliktin midis Kosovës dhe Serbisë është politikisht shumë relevant. Ndarja ka rreziqe dhe dobi. Cilat janë rreziqet dhe cilat janë dobitë prej saj?

Në një studim që kemi bërë për luftërat civile bashkë me Nicholas Sambanis, ne nuk kemi gjetur asnjë dëshmi që të thotë se ndarja mund të ndihmojë për të ulur shanset që konflikti të kthehet sërish. Përveç kësaj, ndarja mbart me vete rreziqe për konflikte të reja të brendshme në pjesët e ndara ose konflikte midis dy pjesëve të ndara. Dhe, ne nuk duhet të harrojmë se gjatë gjithë historisë ndarja ka qenë e shoqëruar me kosto të mëdha humanitare, përfshirë shkatërrimin e komuniteteve dhe vdekjen.

Deutsche Welle: Çfarë efektsh ka ndarja territoriale e propozuar?

Nëse i referoheni propozimit serb për ta bërë verium e Kosovës pjesë të Serbisë, ai ka dy rreziqe kryesore. Kjo ndarje "etnike" do të sillte pasiguri për komunitetin serb që do të vazhdonte të qëndronte në Kosovë. Dhe do të krijonte mundësinë për përpjekje të tjera për ndarje etnike në të ardhmen, ndarje që do të bazoheshin në precedentin që vendoset.

Deutsche Welle: Në artikullin tuaj ju thonë se ndarja mund të funksionojë nën disa kushte. Cilat janë këto kushte?

Ne kemi thënë se nuk mund të marrim parasysh të gjitha mundësitë teorike që thonë se ndarja mund të ndihmojë në arrijtjen e qëllimeve të caktuara, nëse plotësohen parakushtet shumë strikte. Por në praktikë, disa parakushtet, si për shembull mungesa e atyre që quhen xhepa (pocket) të pakicave minoritare në territoret e dy shteteve pas ndarjes, janë të pamundura që të arrihen.

Sa i përket propozimeve që diskutohen tani për Kosovën dhe Serbinë, është e rëndësishme të pyes, cilat janë problemet që mendohet të zgjidhen? Dhe a mund të pritet që ndryshimi territorial do të zgjidhë ato? Propozimet janë bërë në kontekstin e Kosovës dhe Serbisë që dëshirojnë të normalizojnë marrëdhëniet, në mënyrë që të arrijnë antarësimin në Bashkimin Evropian. Me sa duket të dy shtetet posedojnë mekanizma të tjerë për normalizimin e marrëdhënieve, përveç përpjekjeve për ndryshime territoriale.

Deutsche Welle: Një pjesë e komunitetit ndërkombëtar mbështet ndarjen dhe një pjesë e kundër-



shton atë. Pse?

Unë nuk di që të ketë ndonjë segment të komunitetit ndërkombëtar që të mbështesë ndarjen në këtë rast. Por për fat të keq duket se kemi të bëjmë me rastin, që ose prej mungesës së eksperiencës së administratës së Trumpit, paqëndrueshmërisë, ose thjesht paaftësisë në politikën e jashtme, liderëve të Kosovës dhe Serbisë nuk u është dhënë një mesazh shumë i qartë i

kundërshtimit të Shteteve të Bashkuara për ndryshimet territoriale. Dhënia e një mesazhi është i domosdoshëm për të ulur tensionet dhe rreziqet e bërjes gabim të llogarive.

Deutsche Welle: Në artikullin tuaj ju flisni për ndarje pas luftës civile. Kosova dhe Serbia nuk janë në luftë. Por ato nuk janë as në paqe. A është ndarja zgjidhja e zinxhirit të konflikteve në

Jugosllavi?

Studimi ynë ka treguar se ndarja nuk është zgjidhje për luftë civile. Nëse mund të zgjidhë problemet politike në një ambient post-konflikti është çështje tjetër, por edhe faktorët që e bëjnë ndarjen të mos jetë në gjendje të parandalojë kthimin në luftë civile dëmtojnë aftësinë e saj për të zgjidhur problemet politike të post-konfliktit. Më shumë se do të zgjidhte një problem ekzistues, ndarja do të krijonte një problem tjetër duke ndezur konflikte të reja për shpërndarjen ose konflikte të bazuara në identitet. Ata që mbrojnë idenë e ndarjes duket se çuditërisht injorojnë faktin që pushteti është në thelb të politikës. Shihni ndarjen etnike. Nëse dy grupe do ndaheshin në mënyrë perfekte nga një ndarje, a do të ishte e mundur që të mos kishte luftëra të reja për pushtet në secilin nga grupet etnike, ose do të përjashtonte ndarja e popullsisë çdo mundësi për konflikte midis tyre?

Studimi të cilit i referohet kjo intervistë është shkruar nga Nicholas Sambanis dhe Jonah Schulhofer-Wohl.

Aida Cama

## HOROSKOPI

### DASHI

Sot do të ndiheni në tension për disa punë që i keni lënë pa përfunduar. Kuptoni se gjërat po lëvizin me shumë shpejtësi këto ditë ndaj ndiheni i papërgatitur veçanërisht për ndryshimet në jetën tuaj.

### DEMI

Mund të përballeni me shumë zhgënjime nëse përqëni të luftoni rreth aktualit. Çështja kryesore është që çfarëdo situatë ku ndodhni ta shfrytëzoni për të mirën tuaj. Te qarat nuk ju zgjidhin problemet.

### BINJAKET

Mbajtja e gjërave në ekulibër sot mund të jetë e ndërlikuar për ju. Ekziston një forcë e ashpër, e cila lufton kundër këtij pozicioni. Kujdes nga kjo energji e fuqishme që është e përqendruar dhe e guximshme.

### GAFORJA

Gjërat mund të jenë të vështira dhe agresive sot, por kjo nuk do të thotë që nuk mund të përparosh veçanërisht në aspektin financiar. Ekziston një energji që rrit njerezit të vepronjë. Mund të mësoni disa mësimë të vlefshme duke dëgjuar të tjerët.

### LUANI

Sigurohuni që betejën që nisni ta fitoni ju. Ka shumë tension në ajër që mund të shpërthejë kur ju e prisni më pak. Mendoni me qetësi duke mos i marrë gjërat shumë seriozisht. Shpirti juaj i fortë i zgjidh të gjitha situatat.

### VIRGJERESHA

Mos u mundoni të luftoni njerezit që janë aq kokëfortë sa refuzojnë të shohin një perspektivë tjetër. Në të njëjtën kohë, sigurohuni që të qëndroni të hapur për pikëpamjet e të tjerëve. Në dashuri tregohuni tolerant.

### PESHORJA

Sot do të mund të ndjeni një lidhje të fortë me anën tuaj imagjinare dhe romantike. Kini kujdes, sepse mund të zbuloni se një forcë e fortë agresive i kundërvihet këtyre ëndrrave. Shmangni personat negativë që ju rethojnë.

### AKREPI

Edhe pse mund të mos pajtoheni me gjithçka që ndodh rreth jush, njerezit kanë arsytet e tyre për mënyrën e veprimit. Mos u tregoni agresiv me ata të cilët mendojnë ndryshe nga ju.

### SHIGJETARI

Disa vendime që i keni marrë mund të mos miratohen. Kjo nuk do të thotë se ju duhet të hiqni dorë, përkundrazi, vazhdoni me të njëjtin ritëm. Nuk do të zhgënjeheni me rezultatit.

### BRICJAPI

Nëse e gjeni veten në një rënie sot, mos u shqetësoni. Shumë shpejt gjërat do të shkojnë mirë për ju veçanërisht në ekonomi. Parashikohet një rritje page ose promovim në detyrë.

### UJORI

Përdorni energjinë e zjarrtë të ditës për të përfunduar disa detyra të lëna pas dore. Në dashuri yjet ju favorizojnë, por ndërkohë duhet të tregoheni më aktiv. Daljet me miqtë këshillohen për ju.

### PESHQIT

Ke një priprje për të qenë agresiv. Duket sikur të doni të shpallni luftë me të gjithë. Përdoreni ditën për të aleanca dhe jo armiqësi. Thoni fjalë të ëmbla edhe ndaj njerezve që nuk janë treguar pozitivë ndaj jush.

**TRAJNERI I SKËNDERBEUT**

Ndeshja midis Kastriotit dhe Skënderbeut ka përfunduar me rezultatin 0-3. Një ndeshje e fituar pastër nga korçarët, të cilët tashmë ndodhen të vetëm në krye të klasifikimit. Ndërkohë menjëherë pas ndeshjes ka folur për mikrofonat e "Supersport" edhe trajneri i Skënderbeut, Orges Shehi, i cili shprehet:

**Duket sikur është i njëjti Skënderbe, me lojtarët nga akademja.**  
Kanë moshë të re dhe nuk kanë aq sa duhet minuta, por kanë cilësi. Dhe ua kemi thënë. Po punojnë mirë dhe po japin maksimumin. Është e merituar, sepse punojnë mirë dhe po duket.  
**Skënderbeu ishte prepotent. Si është ky Skënderbe, është më ndry-**

**she dhe deri ku mund të shkojë?**  
Është i riformatuar. Vjet kishim më shumë akademi dhe sivjet energji. Jemi skuadër e re dhe kemi shumë energji dhe objektivat tanë dihen. S'kemi nevojë t'i themi. Do vazhdojmë me ndeshjen e radhës.  
**A patë ndonjë problem që mund të rregullohet me ekipe më të forta?**

**Shehi: Pres të rikthehet një ish-lojtari ynë**

Jo, ka vend për përmirësim dhe nga ndeshja në ndeshje po i minimizojmë. Shpresojmë që deri në ditë e fundit të merkatos të përforcohemi edhe pak dhe të jemi më të bindshëm. Shpresojmë të fuqizohem edhe me dy lojtarë.  
**Kenë një opsion të mirë në stol, Oto Xhonin.**

Është lojtar me cilësi dhe është i ri. Vjen nga një ligë tjetër dhe ka dëshirë për të punuar. Do të rritet, por për sulmin po i besojmë këtyre çunave të ri dhe unë jam për të rinjtë.  
**Lojtarët që do mbajnë peshën e sulmit?**

Është një ish-lojtar, që ka qenë të ne dhe pa u mbaruar të gjitha nuk do konfirmoj gjë tani. Shpresoj që të vijë dhe nëse nuk vjen do të kemi mundësi që të afrojmë një tjetër, por nga jashtë. Nuk kemi lojtarë në provë dhe e dhamë listën tonë në ndeshje me Pogradecin kemi programuar edhe një me Maliqin. Lojtarët e stollit do luajmë nesër me Maliqin.



Jeton Selimi

Demte dhe dygolëshi i Dejvi Bregut bën që korçarët të ruajnë pikë të plota

# Kampionët thyejnë Kastriotin, ish-i Alla ndëshkon Kukësin

*Në Vlorë, Flamurtari fiton 1-0*



SUPERLIGA		
<b>Ndeshjet</b>		
Tirana - Teuta		0-0
Kamza - Partizani		0-1
Laçi - Luftëtari		2-1
Kastrioti - Skënderbeu		0-3
Flamurtari - Kukësi		1-0
<b>Renditja</b>		
Skuadra	N	P
Skënderbeu	2	6
Laçi	2	4
Flamurtari	2	4
Partizani	2	3
Kamza	2	3
Kastrioti	2	3
Teuta	2	2
Kukësi	2	1
Tirana 2	1	
Luftëtari	2	0

ieri Teqja do të jetë në lartësinë e duhur. Me Kastriotin e hedhur tërësisht në sulm, Skënderbeu gjen hapësirë për të vrarë ndeshjen, teksa në minutën e 85-të Dejvi Bregu finalizon saktë kundërsulmin e nisur nga Oto Xhon. 3-0 dhe ky do të jetë rezultati përfundimtar i një 90 minutëshi të dominuar nga kampionët në fuqi, që e kanë nisur mbrojtjen e kurorës në mënyrën e duhur në këto javë të para.

Flamurtari i Ilir Dajës ka arritur të fitojë ndaj Kukësit në një ndeshje të luftuar dhe në një terren në nivele mediokre, por që u lejoi vlonjatëve të thyenin verilindorët. Golin e vetëm të ndeshjes e shënoi Albi Alla, qendërmbrojtësi që pak ditë më parë kaloi te kuqezinjtë pikërisht nga Kukësi, duke u bërë ndëshkuesi i ish-ekipit të tij.

Në përgjithësi Flamurtari u shfaq më i vendosur dhe krijoi më shumë situata goli në kuadrantin e Malokut, për të kulmuar në minutën e 40-të të takimit kur me kokë tund rrjetën e Kukësit. Pjesa e dytë do të jetë më interesante, pasi Kukësi ka kërkuar dëshpërimisht golin e barazimit, por në lojën e djemve të Cungut mungonte rrjedhshmëria dhe lidhja mes reparteve, çka ja bënë më të lehtë fitoren vlonjatëve, që nga ana e tyre mund të kishin dyfishuar në disa momente. Gjithsesi do të mbyllet 1-0 me Flamurtarin që ngjitet në kuotën e 4 pikëve, po aq sa edhe Laçi, ndërsa Kukësi ndan vendin e parafundit të renditjes me Tiranën në kuotën e 1 pike.

Pasi mundi Partizanin në javën e parë të kampionatit, Skënderbeu u lëshon një tjetër sinjal të fortë rivalëve, duke demonstruar se marrja e kurorës së kampionit nga korçarët do të jetë një detyrë e vështirë. Në fushën sportive "Redi Maloku" të Fushë-Krujës, kampionët udhëtonin për t'u ndeshur me Kastriotin e Krujës. Sfida nis menjëherë me bardhekuqtë që u imponohen rivalëve debutues në superiore, ndërsa në minutën e 16-të do të vijë dhe goli i parë me autor Demten, që finalizon saktë një aksion të rrjedhshëm nga e djathta. Skënderbeu dominon dhe e vë rezultatin në kasafortë 14 minuta më pas, kur Dejvi Bregu ekzekuton saktësisht një goditje dënimi duke e lënë të palëvizur portierin Kuka. Rezultati 2-0 bën që të besuarit e Shehit të ulin ritimin, ndërsa Kastrioti përpqitet në pjesën e dytë të rikthehet në lojë, por edhe në ato çaste kur mund të kërcënojë, (minuta 47 dhe 81 rastet për ilustrim) port-

por duhet të shohim përpara.  
**Zërat e merkatos a ndikojnë te loja në ekip?**  
Nëse më bëni pyetje për ndeshjen, jam gati të përgjigjem. Nëse më pyesni për kontratat, ato nuk i kam bërë unë, dhe nuk përgjigjem për ato. Unë e kam theksuar, nuk ka arsye pse të ketë probleme me individë. Kush është profesionist, duhet të pranojë konkurrencën. Nëse nuk ka konkurrencë, nuk ka grup. Unë duhet të mbroj grupin, dhe ata lojtarë që kërkojnë të ecin përpara dhe të vazhdojnë në nivele të larta. Kush nuk i bindet këtij rregulli, e përjashton vetë futbollin, as trajneri e as ndonjë drejtor.  
**Futja e Qazit dhe ndryshimi i modulit**  
"Nuk ishte e papritur. Që kur nisi pjesa e dytë, kaluam në 4-4-2, me Harbën në sulm.

**Situatë e ndërë te Kukësi**

**Cungu kundër Nexhipit: Kontratat nuk i bëj unë**




Edhe 30 minutat e fundit, sakrifikuam duke kaluar në 3-4-1-2. Disa momente ekipi u shpreh mirë, e dija që do kishim probleme mbrapa. Ekuilibrat na u prishën, edhe me dëmtimin e Rrumbullakut. Mbetëm edhe në inferioritet numerik. Tentuam me disa goditje këndi, por në fund asgjë nuk vlen nëse nuk shënon. Nuk pashë një Kukës apatik, thjesht gabuam tek momenti i golit të kundërshtarit."  
**Terreni, pengesë për ndeshjen e sotme**  
"Të kesh këtë terren në Superligë, lë shumë për të dëshiruar. Duhet një futboll

më i bukur. Edhe ne si trajner japim udhëzime për të pasur kujdes kur kthejnë topin lojtarit, dhe kjo gjë të

penalizon kur duam të nisim topin. Nuk mund të luajmë vetëm me topa të gjatë."

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Me të nxjerrin një tapë.
4. Inicialet e Klee piktor.
6. Qiritaq aktor.
9. Etikë pa kufij.
11. Merren për shembull.
14. Fund janari.
17. Ortolani kompozitor.
18. Ushtrohej edhe nga bukanierët.
20. Në krye të sonzadrës.
21. Janë të ndaluar në kthesë.
23. Entë Rajonale Civile.
24. Gjermania në tabela.
25. Mund të jetë unik.
27. Philippe që qe aktor.
29. Një pjesë e pelegrinazhit.
31. Gjysmë leader.
32. Maten pa zë.
33. Janë të përpjeta.
35. Qytet anglez.

36. Louis, poet surrealist.
38. Artet pa re.
39. Matet pa kufij.
40. Gruaja e Ben Hur.
42. Liam i Schindler's list.
45. Të parat në orkestër.
47. Makina lbiza.
48. Renato, piktor i famshëm italian.
49. Mihali këngëtare lirike.

**VERTIKAL**

1. Mbyllin fushata.
2. Një pjesë e pikturave.
3. Janë njëvjeçarë.
4. Një ngjyhet në tavolocë.
5. Eshhtë katolik ai i papës.
6. Mbyllin portat.
7. Opera e Mascagni-t.
8. Tregohet duke bërë masakra.
10. Janë aftësi prodhuese të fabrikës.

11. Një gjuajtës francez.
12. Eshhtë porti i Durrësit.
13. Kërkojnë origjinën e fjalës të tillë.
16. Pak pirografi.
19. Një pjesë e aerobisë.
21. U vodhi zjarrin përendive.
22. Premtojnë të bëhen asa.
23. Mbeten në fund.
26. Rreth pa ekstreme.
28. Rendi pa zë.
29. Eshhtë veshje thahitane.
30. Tase e volejbolit.
33. Eshhtë shahu i fundit.
34. Kim... Stuart aktor.
35. Fritz regjisor.
37. Ai i shtatë është kinemaja.
39. Një pjesë e ansambllit.
41. Diftong teatral.
43. Të parat në stacion.
44. Qendër në tour.
46. Mbarojnë fare.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**

1. Harris aktor.
3. Termocentrali i shkurtër.
5. Organizata me koska.
10. Një tufë bagëtitsh.
12. Inicialet e Redford.
14. Kështu thonë se bëhet ai që mërziat.
15. Scarlet e Bashkë e erën.
17. Elvira aktore.
19. Eshhtë Panorama që ke në dorë.
21. Ushtojnë nga "ola".
22. Shtet aziatik.
24. Eshhtë ministri.
25. Në radhtë të parë.
26. G... për njerëzit e FBI.
27. Makina Micra.
31. Mund të jetë proteste.
32. Pasur pa kufij.
33. Gjika e Dora d'Istria.
36. Të fundit në dhjetor.


**VERTIKAL**

1. Umberto që shkroi Baudolino.
2. Bertë këngëtare italiane.
3. Fillojnë një temë.
4. Një garë në hipodrom.
6. Qe burri i parë.
7. Një ndriçues.
8. Bëjnë shirit me shi.
9. I dha fillin Tezeut.




10. Vihen për të mbyllur.
11. Para Saint-Germain në futboll.
13. Qëllon në një vend.
16. Eshhtë dosja e të pandehurit.
17. Janë përmasat.
18. Mbush në kufij.
20. I bëjnë duart me ar.
21. Inicialet e dalt piktor.
23. Fillojnë argumentin.
28. Makina lbiza.
29. Emri i Einstein.
30. Ndrriçojnë rrugët.
31. Kim që qe aktore.
32. I hedh i dorzuar.
34. Inicialet e Nolte aktor.
35. Ishin rapsodët e akejve.
37. Fund shkurti.
40. Van der portier holandez.
44. Fillojnë masat.
46. Inicialet e Rohmer.
47. Fillojnë teorikisht.
49. Numër i shkurtër.

**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

A	L	E	X	S	G	P	O	A	Z	I		
M	I	S	H	N	D	O	R	E	S	H	R	
A	R	A	M	O	G	O	A	U	T	O		
M	K	I	M	N	O	V	A	K	O	N		
P	S	E	R	I	A	L	I	A	R	T	I	
T	R	E	N	D	I	M	I	O	K	E		
R	O	N	A	L	D	O	I	G	A	E		
M	A	L	E	N	G	O	R	E	T	E		
B	A	T	A	R	I	A	T	E	R	O	R	
I	R	O	N	A	C	E	M	Y				
L	I	R	I	K	E	P	A	R	O	D	I	A
L	O	T	R	A	C	O	R	O	T	K	N	

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

F	A	L	L	I	K	F	S	D	O	R	A	
A	D	A	M	P	A	L	I	M	I	N		
L	E	M	T	A	B	E	L	A	T	M	I	T
A	T	K	A	P	I	T	U	L	L	I	M	I
N	M	A	R	I	N	A	R	I	F	I	L	
G	R	E	M	I	N	A	U	E	F	E		
A	R	I	F	D	E	N	T	I	S	T		
C	P	I	K	A	T	E	S	E	R	T	E	
C	I	T	A	T	E	M	E	T	O	R	E	
O	S	H	Z	E	R	A	M	T	E	R		
S	H	T	E	P	I	T	E	L	E	J	A	
A	E	K	A	M	I	N	I	S	A	R	I	

**SUDOK**

6	1	9							
			3				9	1	2
3	7			4				8	
	8	5	7					4	
		4	3	5			2		
4									
5	9		2	6					3
					5				6

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

7	1	6	2	8	4	9	3	5
5	4	8	3	7	9	6	1	2
2	9	3	1	5	6	4	7	8
4	7	9	5	6	2	1	8	3
3	8	1	4	9	7	5	2	6
6	5	2	8	1	3	7	9	4
9	2	7	6	3	5	8	4	1
8	3	5	7	4	1	2	6	9
1	6	4	9	2	8	3	5	7

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

*Argëtim filozofik*

- Sa qetësi do të mbretëronte sikur njerëzit të thonin vetëm atë që dinë.
- Njeriu duhet të ndalet para se t'i ketë thënë të gjitha. Të shumtët i kanë thënë të gjitha, para se t'ia fillonin.
- Njerëzit janë duke luftuar më shumë për interesat e tyre se sa të drejtat e tyre.
- E drejta për të thënë mendimin tënd, nuk nënkupton automatikisht të drejtën të të marrin seriozisht.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

3	P	U	S	I	15	2	3	5	7	3	
2	4	8		4	7	8	6		9	1	
6	1		3	10	9	10	4	1	11	8	5
12		3	8	11	7	4	8	13	8		5
5	4	1	3	8	11	7	16	7	13	8	
10		3	8	5	8	5	1	11	8	5	
5		10	6	8	1	5		5	7	18	
1	8	4			3	4	8	11	1	13	10
	4	1	17	12	8	10	4		6	1	9
6	5	1	9	10	5		10		2	15	10
4	2	16			8		2	15	10		
4	1	17	12	8	4	18		5	8		

A	R	T	M	K	R	I	M	B	A	T
N	G	U	J	I	M	U	A	N	E	
I	B	A	N	I	M	K	H	M	E	R
J	H	K	A	N	I	B	A	L	E	T
E	B	O	T	E	R	O	R	E	T	
L	A	B	O	R	A	T	O	R	E	T
H	A	I	R	V	A	N	T	O	R	
R	E	N	E	A	N	T	R	E	H	
A	V	E	T	V	I	I	I	G	U	
K	A	N	T	M	E	K		T	I	N
U	T	I	B	E	T	A	T	E	M	E
J	R	R	U	G	A	A	R	T	E	T

*Thënie të mënçura*

- Kam qenë egoist në tërë jetën time, por vetëm në praktikë, kjo nuk ishte çështje parimi.
- Sikur të mund t'i bindja njerëzit të më frikësohen, më kënaqësi do t'i bindja të më duan.
- Shumë justifikime janë gjithmonë më pak bindëse se një.
- Njeriu që ka shumë të flasë me veten, u largohet bisedave me të tjerët.
- Asnjëherë njeriut nuk i nevojitet më shumë mënjuri, sesa atëherë kur ka punë me mendjelehtë.

